- vlerëson tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit
- vlerëson prirjet e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës.

b. Qëndrimet dhe vlerat**Në përfundim të nëntematikës nxënësi/-ja:**

- Vlerëson dhe respekton diversitetin social, kulturor dhe mjedisor;
- Paraqet dhe komunikon lirshëm mendimet e tij;
- Respekton përpjekjet personale dhe ato në grup;
- Tregon integritet në aksesimin dhe përdorimin etik të informacionit;
- Është krijues dhe prezanton idetë e reja të tij.
- Ndan me të tjerët përvojat dhe njohuritë e përftuara nga vëzhgimet individuale;
- Respekton idetë dhe përvojat e prezantuara nga të tjerët;

PLANI SINTETIK DHE ANALITIK

Nr	Nëntem- atika	Temat Mësi- more	Situatë e parashikuar e të nxënit	Metodologjia dhe vep- rimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1	2.6 Bashkimi European 6 orë	1. Vështirësitë dhe për- parimet në procesin e Integrimit në Bashkimin European	Duke u nisur nga njohu- ritë e temave të kalu- ara, rikujtoni krijimin e Komunitetin Ekonomik European	Parashikim me terma paraprakë/Diskutim Shënime të strukturu- ara/Punë me teks- tin-mbajtje shënimesh Diskutim/ Diskutim për- fundimesh	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
2		2. Bashkimi Europi- an-Bazat e tij	Çfarë është Bashkimi Eurropan dhe si funk- sionon ai ?	Diskutim për njohuritë paraprake/Diskutim idesh Shpjegim i përparuar/ Diskutim Organizues grafik i infor- macionit-Skemë/Paraqit- je grafike e informacionit	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
3		3. Procesi i zgjerimit të Integrimit Euroatlantik	Çfarë rëndësie do të kishte për Shqipërinë integrimi i saj në BE ? Po për NATO-n çfarë dini ?	Stuhi Mendimesh/Disku- tim idesh Organizues grafik i informacionit/Paraqitje grafike e informacionit Punë me hartën/ Disku- tim përfundimesh	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
4		4. Bash- këpunimi Rajonal në Ballkan forcon demokracinë dhe begatinë	Çfarë dini ju për Luftën e Kosovës me Serbinë?	Parashikim/ Diskutim idesh VMLD(Veprimtari me lexim të drejtuar)-Lex- im-Diskutim-Shënime Diskutim/Diskutim për- fundimesh	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
5		Projekt kërki- mor-Ora IV Kontributi i shqip- tarëve në mbrojtjen e Hebrenjve gjatë Luftës së II B.	Ju tashmë e dini se ç'përfaqësojnë projek- tet. Paraqitni mënyrës e punës që keni ndjekur deri në këtë fazë të projektit.	Diskutim/Diskutim i ideve Punë me grupe/Punë me grupe Diskutim/Diskutim i ideve	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
6		Projekt kërkimor Ora V: Kontributi i Shqip- tarëve në mbrojtjen e Hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.	Puna e nisur nga ju që në fillim të vitit shkollor vjen e përfunduar në trajtën e një produkti projekti në formën/ at e zgjedhur/a prej jush, për të marrë një vlerësim të tipit përm- bledhës, për shkak të shtrirjes, njohurive, sh- kathtësive, qëndrimeve dhe vlerave që ju do të demonstroni.	Diskutim/Diskutim i ideve Prezantim/Prezantim projekti Diskutim/Diskutim për- fundimesh	Vlerësim individ- ual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjig- jeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti

7	2.7 Prirjet e qytet-ërimeve sot 8 orë	1. Shkenca dhe Teknologjia ndryshojnë botën	NASA revolucion i teknologjisë së informacionit, Juri Gagarin, hëna. Cila është lidhja që kanë këto terma me njëri-tjetrin?	Parashtrim me terma paraprakë/Mbajtje shënimesh Mbajtje e Strukturuar e shënimeve/Diskutim-Studim teksti Diskutim/ Diskutim përfundimesh	Vlerësim individual, ndërnxënës.	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
8		2. Zhvillimi ekonomik global	Cilat janë llojet e energjisë që përdorni më së shumti nga shoqëria sot ?	Diskutim për njohuritë paraprake/Diskutim idesh Shpjegim i përparuar/ Diskutim Diskutim/ Diskutim përfundimesh	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
9		3. Lëvizjet e reja sociale-protesta kundër globalizmit	Duke pasur parasysh pasojat e globalizmit, themi që reagimi i popujve ndaj tij nuk ishte pozitiv. Lindën të ashtuquajturat Lëvizje antiglobaliste, Si mendoni cilat janë kërkesat e këtyre lëvizjeve ?	Marrëdhëniet pyetje-përgjigje/Shënime Marrëdhëniet pyetje-përgjigje/Studim i thelluar I tekstit-Diskutim Shkrim i shkurtër/ proces I të shkruarit	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
10		4. Prirjet e sotme në kulturë dhe shoqëri	Coca-cola është një ndër pijet tuaja të preferuara. Po veshjet dhe musika juaj e preferuar cila është?	Diskutim për njohuritë paraprake/ Diskutim i ideve Diskutim/Diskutim Diskutim/Diskutim përfundimesh	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
11		Veprimtari praktike 11: Republika e pavarur e Kosovës- një e drejtë e mohuar për një popullsi në shumicë	Çfarë dini ju për luftën e Kosovës dhe pavarësinë e saj? Ç' përfaqësojnë për këtë ngjarje emrat Adem Jashari dhe UÇK ? Shprehni mendimet tuaja.	Brainstorming/ Diskutim idesh Punë në grupe/Prezantim Prezantim/ Diskutim Prezantim/ Prezantim pune-shënime	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
12		Përsëritje: Prirjet e qytetërimi sot	Ju tashmë keni marrë përgjigje rreth shumë pyetjeve të shtruara këtë kapitull. Proveni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.	Parashikim (Stuhi Mendimesh)/Diskutim idesh Harta e koncepteve të kapitullit/Organizim grafik i informacionit Diskutim/ Diskutim përfundimesh	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti
13		Testim: Bashkimi Europian-Prirjet e qytetërimi sot.	Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbledhës që është i detyrueshëm në fund të çdo tremujori.	Përdorim informacioni analizë/ punë e pavarur individuale	Vlerësim individual, ndërnxënës. Vlerësim i përgjigjeve me gojë	Historia VIII Harta të ndryshme Interneti

PERIUDHA E TRONDITJEVE TË MËDHA (1914-1945)
REZULTATET E TË NXËNIT ME KOMPETENCA

NXËNËSI:

- identifikon shkaqet e dy luftërave botërore.
- dallon blloqet kryesore ushtarake ne prag të tyre.
- tregon dhe gjykon rrjedhojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të dyluftërave botërore.
- vlerëson rolin e institucioneve europiane dhe ndërkombëtare në zgjedhjen e konflikteve të Luftës I dhe të II Botërore.
- gjykon arsyet dhe vlerëson rëndësinë e krijimit te Lidhjes së Kombeve.
- shpjegon dhe gjykon rrugët dhe shkaqet e ardhjes ne pushtet të qeverisjeve totalitare.
- identifikon tiparet e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939.
- portretizon figurat e sistemeve kryesore politike ne vitet 1920-1939.
- identifikon dhe gjykon shkaqet dhe pasojat e krizës 1929-1933.
- vlerëson politikat e ndryshme që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA-të për të dalë nga kriza ekonomike.
- shpjegon ndryshimet sociale, kulturore dhe shkencore që pësoi shoqëria në periudhën midis dy luftërave botërore.
- dallon ndryshimet ndërmjet tipareve të shoqërive totalitare me ato të shoqërive demokratike.
- identifikon karakteristikat e artit dhe kulturës në vitet 1920-1939.
- shpjegon dhe gjykon pasojat e holokaustit.



Europa në prag të luftës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Europa në prag të luftës		Situata e të nxënës: Lufta I Botërore nuk është një ngjarje e panjohur për ju. Kjo ndodhi për një sërë arsyes. Çfarë dini ju për të?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan Perëndimin e zhvilluar, duke u ndalur në karakteristikat e tij . - Zbulon arsyet që i bënin vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore vende të prapambetura. - Zbërthen kuptimin e termave Aleancë Trepalëshe, Antanta Trepalëshe. - Portretizon botën në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore. - Analizon përçarjen e Europës dhe interesat e saj në Ballkan në shek. XX		Fjalët kyçe: korporatë, politikë imperialiste, Aleancë Trepalëshe, Antanta Trepalëshe, paqe e armatosur, Lidhja Ballkanike.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, internet, hartë e Evropës dhe botës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u , Gjeografia		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit	Bashkëbisedim	Bashkëbisedim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Shpjegim hap pas hapi	Diskutim-punë në hartë	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit	Punë e pavarur	Shpjegim skeme	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'

Ora e parë e vitit shkollor është një mundësi e mirë për mësuesin të prezantojë lëndën si dhe synimet e tij në raport me klasën. Mësuesi për të arritur këtu ndërton disa pyetje të thjeshta: • Çfarë keni studiuar gjatë vitit të kaluar në lëndën e Historisë? • Cilat tema mësimore ju janë dukur interesante dhe pse? • Çfarë do të dëshironit të studionit në këtë vit shkollor? • A keni lexuar gjatë verës libra me përmbajtjen historike? • Nëse po ju lutem flisni shkurtimisht rreth tyre. Në përfundim të kësaj faze, mësuesi kalon në prezantimin e përmbajtjes së shkurtuar të lëndës dhe shënon në tabelë disa objektiva kryesore, që janë në përputhje me nivelin e klasës.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Hapi i parë: Mësuesi paraqet në hartë disa nga shtetet kryesore të Evropës Perëndimore. Më pas emrat e tyre i liston në tabelë: Gjermani, Francë, Austri, Angli, Holandë, Belgjikë etj. Fton nxënësit që të studiojnë grafikun që pasqyron mbizotërimin e tregut botëror dhe të nxjerrin nga legjenda se cilët janë shtetet më të zhvilluara. Vendos pranë emrave në tabelë shenjën V për këto shtete. Në përfundim liston disa nga faktorët kryesorë që i ka bërë këto shtete të dallojnë nga të tjerët. 1. Urbanizimi. 2. Struktura shoqërore e larmishme. 3. Treguesit socialë të lartë.

Hapi i dytë: Mësuesi krijon një skemë krahasuese përballë vendeve të zhvilluara dhe vendet e prapambetura. Edhe këtu fillimisht i liston disa nga vendet e Evropës Lindore dhe Juglindore si dhe vende të kontinenteve të tjera. Ftohet një prej nxënësve t'i tregojë në hartë. Më pas mësuesi shkruan disa nga arsyet që kanë çuar në këtë prapambetje. 1. Vende me strukturë rurale. 2. Struktura sociale kishte pak larmishmëri. 3. Qeveriseshin nga regjime monarkike. 4. Struktura klasore e ngurtë. 5. Zhvillimi i pakët i pronës private.

Hapi i tretë: Mësuesi shkruan fjalën baraspeshë. Kërkon nga nxënësit të japin një përkufizim të përgjithshëm për fjalën. Më pas kalon në kontekstin e fjalës në çështjen mësimore. **BARASPESHË-** Zhvillimet e vendeve të kishin baza të njëjta dhe përfitimet të ishin për të dyja palët. Cila ishte panorama historike? • Burimet natyrore dhe kapitalet ishin të shpërndara në vende të ndryshme. • Në marrëdhëniet ndërkombëtare ishin shfaqur prirjet militariste. (rreziku i luftërave). Gjithashtu në tabelë shkruhen dhe aleancat e krijuara para Luftës ku në njërin anë kishim **Aleancën Trepalëshe:** Gjermani, Austri, Itali dhe në anën tjetër u krijua **Antanta Trepalëshe:** Britani, Francë, Rusi. Këto aleanca krijohen si rezultat i rivalitetit të këtyre shteteve midis tyre.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit 10'

Nxënësit punojnë me hartën:

Lexoni hartën- Formimi i Aleancave në Europë. Shpjegoni çfarë kuptuat?

Vëreni hartën humoristike, Europa në prag të Luftës së I-rë Botërore. Emërtoni vendet dhe tregoni çfarë shprehin karikaturat e secilit vend.

Punoni me foton në tekst: Çfarë mesazhi merrni prej saj?

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Lidhni temën e ditës me Shqipërinë: Cili shtet europian interesohej për Shqipërinë? Pse?



Lufta I Botërore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Lufta I Botërore	Situata e të nxënit: Çfarë dini ju për luftërat botërore me siguri keni dëgjuar për to. A është përfshirë Shqipëria në to?			
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston prirjet që çuan në kundërshti mes sistemeve dhe sfiduan progresin. - Rendit shkaqet e fillimit të luftës. - Evidenton dallimin midis shkaqeve dhe pretekstit real të fillimit të luftës. - Përshkruan si gjetën shprehje militarizmi/ imperializmi i ri në ecurinë e Luftës së Parë. - Rendit në blloqe shtetet pjesëmarrëse në luftë. - Analizon synimet e luftës dhe përfundimin e saj.	Fjalët kyçe: Pretekst, Franc Ferdinand, Sarajevë, luftë botërore, blloqe ndërluftuese, fronte luftimi			
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, hartë e Evropës dhe botës, hartë memece	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia, Shkencat shoqërore			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit	Stuhi mendimesh	Diskutim idesh	5'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar	Mbajtje shënimesh/punë në dyshe	30'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit	Rrjeti i diskutimit	Diskutim	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Shkruhet nga mësuesi në tabelë termi “Luftë Botërore”. Kërkohej nga nxënësi të plotësojnë skemën me ide/ fjalë me të cilat e lidhin këtë togfjalësh. Në përfundim të kësaj faze mësuesi shkruan në tabelë temën e mësimi dhe tërheq vëmendjen e nxënësve me pyetjen: 1. A dini se sa Lufta Botërore janë zhvilluar ? 2. A është përfshirë Shqipëria në to?

Përfshihen shumë vende
Lufta e Parë Botërore
Beteja të mëdha

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësve u sugjerohet nga mësuesi informacioni që duhet lexuar në tekst, duke i nxitur të mbajnë shënime, të mendojnë, reflektojnë e të nxjerrin përfundime, duke diskutuar me shokun e bankës, mësuesin, për të saktësuar konceptet e për të marrë përgjigje për pyetjet që lindin. Të gjitha veprimtaritë e lartpërmendura bëhen të fokusuar duke i dhënë përgjigje pyetjeve:

- Cilat ishin shkaqet e fillimit të Luftës I Botërore?
- Pse Ballkani u bë qendër e shpërthimit të luftës?
- Cilat ishin Frontet e Luftës?

Përfundimet e nxjerra diskutohen para klasës dhe evidentohen në dërrasë nga nxënësit.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Për përforcimin e njohurive të marra gjatë orës së mësimi, në përfundim me te gjithë klasën punohet me rubrikën e tekstit Puno me tabelën. Edhe këtu klasa ndahet në grupe. Grupi i parë përcakton kuptimet e koncepteve militarizëm, imperializëm. Grupi i dytë bën radhitjen e shteteve sipas blloqeve. Grupi i tretë ngjyros në hartën memece me dy ngjyra blloqet (p.sh blu Antanta/ e kuqe Blloku Trepalësh.

Nr	Frontet	Betejat/ humbjet në njerëz
1		
2		

Vlerësimi:	
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me plotësimin e tabelës, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.	
Detyrat dhe puna e pavarur:	
Kërkoni informacion: Lidheni me të sotmen, shkruani një raport të shkurtër mbi marrëdhëniet e sotme midis shteteve anëtare të Aleancës Trepalëshe dhe Antantës Trepalëshe.	



Pasojat e luftës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Pasojat e luftës		Situata e të nxënit: Pasi trajtuam ngjarjet gjatë Luftës I. Si mendoni ju, çfarë pasojash ka sjellë kjo luftë për shoqërinë?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: · Evidenton pasojat e Luftës së I në të gjitha aspektet e jetës njerëzore. · Krahason ndryshimet politike e shoqërore të para luftës me ato të pas luftës. · Pasqyron rolin e gruas në shoqëri pas lufte. · Argumenton arsyet që e bënë Europën të humbë rolin e saj parësor pas lufte. · Mban qëndrim kritik për efektet e ngjarjeve të tilla në shoqërinë njerëzore.		Fjalët kyçe: Pasoja të luftës, Vladimir Iliç Lenin, revolucioni Bolshevik		
Burimet / Mjetet / Materialet: Materiale filmike, foto, teksti i historisë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-U, Shkencat shoqërore		

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit	Përvijim i të menduarit	Diskutim i ideve	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Organizuesi grafik i informacionit/ Shpjegim i përparuar	Paraqitje grafike e informacionit	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Tema paraqitet me anë të një “Përvijimi të të menduarit”, nga mësuesi, si dhe nga foto që tregojnë forma karakteristike. Kjo i nxit nxënësit të rikujtojnë njohuritë e tyre të mëparshme dhe të bëjnë lidhjen logjike të tyre me temën e re. Përvijimi i mëposhtëm i të nxënit i ofrohet çdo nxënësi në një fletë të bardhë.

Lufta I Botërore	Pasoja	1. 2. 3.
------------------	--------	----------------

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Në këtë fazë diskutohen idetë e nxënësve dhe ato paraqiten në tabelë me anë të një Organizuesi Grafik. Duke evidentuar humbjet e mëdha njerëzore dhe materiale të luftës. Pasi nxënësit evidentojnë në listat e tyre gjithçka që dinë, mësuesja shpjegon çështjet njëra pas tjetrës duke u drejtuar pyetjet: Ç’të përbashkëta ka midis listave tuaja dhe atyre që u përmendën në shpjegim? Ç’të rejash mësuat? Gjithashtu, nxënësit i drejtojnë mësuesit pyetje paqartësie. Mendimet e nxënësve plotësohen nga ana e mësuesit.

Lufta e Parë Botërore			
Pasoja	Humbja e rolit parësor të Europës	Ndryshimet shoqërore dhe politike	Roli i gruas në shoqëri
Humbje njerëzore	- U varfërua dhe u dobësua - Gjermania ishte në kaos	Një shtresë shoqërore përfitoi nga lufta	Gratë punonin
Humbje materiale	- Në Rusi ndodhi Revolucioni Bolshevik	Shembulli sovjetik tek punëtorët	Në SHBA dhe Angli fituan të drejtën e votës.
Varfëri	-Britania dhe Franca u morën me rimëkëmbjen ekonomike	Shtrenjtim i jetesës	

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Në këtë fazë u kërkohej nxënësve të nxjerrin përfundime që mësuesi/ja i konsideron të rëndësishme. P.sh : Çfarë ndodhi me çështjen shqiptare pas Luftës së Parë Botërore? Çfarë efektesh solli në psikologjinë e njerëzve kjo luftë?

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, saktësinë e përgjigjeve të dhëna, vlerësim ndërnxënës dhe përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Shkruani një raport të shkurtër për pasojat e Luftës së Parë Botërore në Shqipëri.



Vendosja e paqes

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Vendosja e paqes		Situata e të nxënës: Lidhja e Kombeve dhe presidenti Udro Uillson nuk janë të panjohur për Shqipërinë. Çfarë dini ju për ta?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan pamjen që synonin t'i jepnin Europës fuqitë fitimtare. - Liston disa nga pikat kryesore të programit të Udro Uillson për paqe. - Argumenton mënyrën e dënimit që iu vendos Gjermanisë. - Analizon arsyet se pse Gjermania e konsideron traktatin e paqes të padrejtë. - Vlerëson rëndësinë e presidentit Uillson për Shqipërinë.		Fjalët kyçe: Udro Uillson, Konferenca e Paqes, Këshilli i të Katërtëve, sistemi i traktateve, vetëvendosje, Lidhja e Kombeve.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Harta politike e Europës dhe botës, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit.	Turi i galerisë	Prezantim informacioni	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Diskutim	Punë me tekstin/ Diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit.	Diskutim /Përcaktim në hartë i informacionit	Diskutim përfundimesh Punë me klasën	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'


Paraprakisht mësuesi u ka kërkuar nxënësve të grumbullojnë elemente figurativë rreth Konferencës së Paqes së Parisit. Nxënësit i kanë ekspozuar nëpër mure dhe disa prej tyre i prezantojnë për klasën.




Udro Uillson



Zhorzh Klemanso



David Llojd Xhorxh



14 Pikat e U. Uillson

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas prezantimit të informacionit nxënësit orientohen të punojnë me tekstin në mënyrë të tillë që të gjejnë përgjigjet e pyetjeve që dolën gjatë fazës së parë, këto pyetje shkruhen në tabelë nga mësuesi:

- Cilat ishin fuqitë fitimtare të Luftës së Parë Botërore?
- Kur u mbajt Konferenca e Paqes dhe vendimet e saj?
- Cilat ishin sanksionet që iu vendosën Gjermanisë?

-Cilat ishin ndryshimet territoriale që u bënë në Europë?
Përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe përfundimet e nxjerra diskutohen në klasë.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Në hartën e Europës nxënësit tregojnë ndryshimet territoriale që u bënë në këtë kontinent pas përfundimit të luftës. Nxënësit nxjerrin përfundimet përkatëse për vendosjen e paqes në Europë si një mision i vështirë i pasluftës.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, për punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Punoni me foton: <i>"Pamje nga salla e punimeve të Konferencës së paqes, Versajë"</i> . Identifikoni përfaqësuesit kryesor të fuqive të mëdha.



Lidhja e Kombeve shpresë për paqe

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Lidhja e Kombeve shpresë për paqe.		Situata e të nxënës: Në temën e kaluar u përmend se një nga vendimet e Konferencës së Paqes ishte formimi i Lidhjes së Kombeve. Pse u formua ajo?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon mënyrën e formimit të Lidhjes së Kombeve. - Përshkruan organet e saj dhe funksionet e tyre. - Liston disa nga sukseset dhe dështimet e Lidhjes. - Analizon rëndësinë e Lidhjes së Kombeve. - Argumenton arsyet që e bënë Shqipërinë të kërkonte anëtarësinë tek ajo.		Fjalët kyçe: Lidhje e Kombeve, Gjenevë, Traktati i Versajës		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletore shënimesh		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës.	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Organizues grafik i informacionit	Paraqitje grafike e informacionit	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënës	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi prezanton temën me anë të situatës së të nxënës dhe u paraqet nxënësve për diskutim një koncept kyç siç është : "Lidhja e Kombeve". Nxënësit diskutojnë në dyshe lidhur me atë që dinë rreth konceptit e pastaj e shprehin para gjithë klasës. Të gjitha idetë e nxënësve paraqiten në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj nxënësit i hedhin një sy të shpejtë informacionit në tekst, ndërkohë që mësuesi paraqet në dërrasë një organizues grafik informacioni, që plotësohet me ndihmën e nxënësve. Për lidhjet që mësuesi ka gjetur tek organizuesi grafik, nxënësit reflektojnë duke mbajtur shënime në fletore në mënyrë që të jenë gati për të kontribuar tek organizuesi grafik i mëposhtëm:

**PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'**

Në këtë fazë nxënësit pasi kanë krijuar idenë e saktë për njohuritë e reja janë gati të diskutojnë për pyetje që u drejton mësuesi. Përfundimet më të arrira evidentohen në dërrasë nga mësuesi.

Vlerësimi:

Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: Pse Shqipëria kërkoi të bënte pjesë në Lidhjen e Kombeve?

**Veprimtari Praktike: Shqipëria gjatë Luftës I Botërore**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari Praktike: Shqipëria gjatë Luftës I Botërore		Situata e të nxënës: Përshkruan gjendjen e Shqipërisë gjatë Luftës I Botërore dhe kupton kontekstin historik të ngjarjeve në të cilën u morën vendimet e drejta dhe të padrejta nga shqiptarët dhe të huajt.		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan gjendjen e Shqipërisë gjatë Luftës I Botërore. - Shfrytëzon burime të ndryshme informacioni për të realizuar veprimtarinë praktike. - Zhvillon aftësitë e tij prezantuese. - Demonstron aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup. - Shpreh aftësinë për të lidhur Historinë me fusha të tjera. - Arrin në përfundimet e duhura në lidhje me temën e veprimtarisë. - Zhvillon aftësitë e të qenit të përgjegjshëm për detyra që i caktohen.		Fjalët kyçe: Princ Vidi, anarkia, KNK.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara.

1. Pse Fuqitë e Mëdha caktuan një princ të huaj, Vidin, për të qeverisur Shqipërinë?
2. A ishte Shqipëria pjesë e ndonjë blloku politik dhe ushtarak të luftës së I Botërore?

3. Pse Greqia e sulmoi Shqipërinë 1914?
4. Pse Italia zbarkoi trupa në Shqipëri (1915) ndërkohë që Mali i Zi dhe Serbia kishin pushtuar Veriun e vendit?
5. Pse ushtria Austro Hungareze i dëboi malazezët dhe serbët nga Shqipëria (1916-1918)?
6. Pse Bullgaria, gjithashtu sulmoi Shqipërinë në 1916?
7. Pse Italia dhe Franca krijuan zonat e mbrojtura të tyre në Shqipëri 1916?
8. Ç' bënë shqiptarët në aspektin politik dhe ushtarak gjatë Luftës I Botërore?
9. Gjeni dëshmi që tregojnë për rezistencën e shqiptarëve gjatë luftës.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që dëshmojnë veprimet e ushtrive pushtuese në Shqipëri si dhe qëndresën e shqiptarëve në forma të ndryshme.

Me fotot, hartat e gjetura nxënësit krijojnë një album, poster, power point, ese me titull :Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore”.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Shqipëria gjatë qeverisjes së Princ Vilhelm Vedit.

Grupi II:

Zonat e pushtimit në Shqipëri gjatë Luftës

Grupi III:

Rezistenca e shqiptarëve gjatë luftës në aspektin politik dhe ushtarak.

FAZA III:10 min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në portofolin e tyre.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer.
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Veprimtari Praktike: Traktati i Fshehtë i Londrës dhe Shqipëria

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha:Mjedisi dhe shoqëria	Lënda:Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari Praktike: Traktati i Fshehtë i Londrës dhe Shqipëria		Situata e të nxënit: Përshkruan gjendjen e Shqipërisë gjatë Luftës I Botërore dhe kupton kontekstin historik të ngjarjeve në të cilën u morën vendimet e drejta dhe të padrejta nga shqiptarët dhe të huajt.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: · Njeh përmbajtjen e Traktatit të Fshehtë të Londrës. · Përcakton karakterin e traktatit. · Analizon pasojat që do të kishte Shqipëria nëse do të ishte zbatuar ky traktat. · Zhvillon aftësitë e tij prezantuese. · Demonstron aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në grup. · Shpreh aftësinë për të lidhur Historinë me fusha të tjera. · Arrin në përfundimet e duhura në lidhje me temën e veprimtarisë. · Zhvillon aftësitë e të qenit të përgjegjshëm për detyra që i caktohen.		Fjalët kyçe: Traktati i Fshehtë i Londrës, Antantë Trepalëshe.		

Burimet / Mjetet / Materialet:

Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point.

Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare:

TIK-u, shkencat shoqërore

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara.

1. Cilat është përmbajtja e Traktati të Fshehtë të Londrës?
2. Cili është karakteri i tij?
3. Çfarë vendimesh kishte marrë për Shqipërinë?
4. Cilat do të ishin pasojat e zbatimit të tij për Shqipërinë?
5. Me kë binte në kundërshtim traktati?

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë përmbajtjen e Traktatit të Fshehtë të Londrës. Me fotot, hartat e gjetura nxënësit krijojnë një album, poster, power point, ese duke evidentuar vendimet e këtij Traktati në lidhje me Shqipërinë.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Përmbajtja e Traktatit të Fshehtë të Londrës.

Grupi II:

Vendimet që u morën për Shqipërinë

Grupi III:

Gjendja politike dhe territoret shqiptare nëse do të ishte zbatuar ky traktat.

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në portofolin e tyre.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer.
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Projekt kërkimor: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës II Botërore.

Ora I e projektit, me temë *Përzgjedhja e temës së projektit*

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedis dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Projekt kërkimor. <i>Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore.</i> Ora I e projektit, me temë <i>Përzgjedhja e temës së projektit</i>		Situata e të nxënës: Ju tashmë e dini se ç' përfaqësojnë projektet. Zgjidhni një temë nga ato që vetë do të propozoni dhe organizohuni për të punuar.		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: · Demonstron pasuri idesh. · Argumenton zgjedhjen e bërë. · Shpreh dëshirë për të bashkëpunuar. · Fiton shprehje për t'u organizuar. · Mëson strukturën e një projekti. · Mëson mënyrën e të punuarit në projekt. · Koncepton miniprojektin.		Fjalët kyçe: Projekt kurrikual, miniprojekt, rezultatet e nxënës gjatë projektit, burime, mjedis pune etj.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Historia 8, Historia 9, Mediat, Interneti, Literaturë historike, Bibliotekat		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkencat shoqërore, TIK-u		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Diskutim	Diskutim i ideve	10'
FAZA II	Zgjidhje problemesh	Mbajtje shënimesh	25'
FAZA III	Diskutim	Diskutim i ideve	10'

FAZA I: 10min

Në mënyrë të shpejtë nxënësit kujtojnë se ç' është një projekt. Pas kësaj mësuesi propozon disa tema lidhur me projektin dhe fton edhe nxënësit të bëjnë propozimet e tyre. Pasi mbaron procesi i propozimeve me shumicë votash nxënësit vendosin për njërin nga temat. Pas kësaj kalohet në organizimin e nxënësve për të punuar.

FAZA II: 25min

Në këtë rast nxënësit orientohen të punojnë në grupe 4-6veta. Nxënësve u shpjegohet se projekti i tyre do të ketë trajtën e një miniprojekti për një përshkrim konkret të nëntematikave që ata do të zgjedhin. Mësuesi orienton nxënësit për strukturën e projektit, burimet dhe mjediset e punës, formën e produktit, natyrën dhe kriteret e vlerësimit.

FAZA III: 10min

Në këtë fazë nxënësit i drejtojnë mësuesit çdo pyetje të mundshme për projektin, duke diskutuar me të dhe shokët sesi mund të zgjidhen probleme të caktuara.

MODEL PROJEKTI PËR NXËNËSIT:

Projekt kërkimor

Lënda: Histori

Klasa: VIIIA

Shkolla

Tema: Kontributi i Shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës II Botërore.

Rezultatet e të nxënës:

-Tregoj rëndësinë e zbatimit të njohurive historike të fituara në mësim në një material të vetëm të punës kërkimore.

-Inkurajohem të përdor njohuritë historike të fituara në mjedisin e sotëm historik.

Aftësi kyçe: punë në grup, aftësi prezantuese, menaxhim i kohës.

Kohëzgjatja e punës kërkimore: Koha nga njëri tremujor në tjetrin.

Koha e shqyrtimit të gjetjeve në klasë: 1orë tremujori i dytë.

Koha e paraqitjes në klasë: 1orë tremujori i tretë.

Puna kërkimore: Individuale apo në grup

Burime të mundshme për t'u përdorur: Shaban Sinani "Hebrenjtë në Shqipëri"; Apostol Kotani "Hebrenjtë në Shqipëri".

Paraqitja në klasë: ese, poster, power point, dokumentar, album etj.

Vlerësimi:

Vlerësim individual për argumentet e përzgjedhjes së temës.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Saktësimi i temës së projektit dhe informacioneve që lidhen me të deri në fazën pasardhëse të projektit.



Revolucioni Bolshevik e shndërroi Rusinë cariste në një shtet totalitar

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Revolucioni Bolshevik e shndërroi Rusinë cariste në një shtet totalitar		Situata e të nxënit: Ju tashmë keni dëgjuar për forma të ndryshme qeverisjeje. Dhe komunizmi nuk është i panjohur për ju duke qenë se dhe Shqipëria e ka pasur një regjim të tillë. Çfarë dini ju për të?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon se si u bë kalimi i pushtetit nga Cari te Bolshevikët. - Përshkruan mënyrën se si Stalini u bë drejtuesi i vetëm i Partisë Komuniste dhe i shtetit sovjetik. - Pasqyron mënyrën e lindjes së totalitarizmit në Rusi. - Analizon arsyet se pse Bashkimi Sovjetik në periudhën midis dy luftërave ishte një vend i izoluar.		Fjalët kyçe: Car Nikolla II, Vladimir Iliç Lenin, Stalini, marksizmi		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Harta politike e Europës dhe Azisë, fletore shënimesh.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore (Filozofia)		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Parashtrim me terma paraprakë	Mbajtje shënimesh-diskutim idesh	5'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Shpjegim i përparuar	Diskutim	30'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi prezanton temën me terma të njohur, duke shfrytëzuar edhe situatën e të nxënit, duke u ndaluar në çështjet kryesore që do të trajtohen. Disa nga termat janë : Komunizëm-Totalitarizëm. Ndërkohë nxënësit mbajnë shënime për çështjet që do të trajtohen.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj atyre u kërkohet që çështjet e parashtruara, në diskutim, me njëri tjetrin, të bëjnë një listë për atë që dinë sipas çështjeve. Pasi nxënësit evidentojnë në listat e tyre gjithçka dinë, mësuesi/ja shpjegon çështjet njëra pas tjetrës, duke drejtuar pyetjen: Ç'gjëra të përbashkëta gjeni midis listave tuaja dhe atyre që u përmendën në shpjegim? Ç'të reja mësuat? Gjithashtu nxënësit i drejtojnë mësuesit/es pyetje paqartësie.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit 10'

Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të nxjerrin përfundime, që mësuesi/ ja i konsideron të rëndësishme, p.sh : Si u bë kalimi i pushtetit nga Cari tek Bolshevikët? Si u bë Stalini drejtues i vetëm i Partisë Komuniste dhe shtetit sovjetik? Cilat ishin tiparet e totalitarizmit sovjetik ?

Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: Kush ishte Karl Marksi? Kush ishte V.I. Lenin? Shkruani me 200 fjalë përfundimet tuaja.



Italia bëhet Fashiste

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Italia bëhet Fashiste		Situata e të Nxënës: Fashizmi nuk është term i panjohur për ju. Si e lidhni ju me figurën e Benito Musolinit (Il Duçe)?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon mënyrën se si e mori fashizmi pushtetin në Itali. - Liston tiparet e fashizmit si regjim totalitar. - Pasqyron marrëdhëniet midis Italisë fashiste dhe Gjermanisë naziste pas Luftës I Botërore. - Analizon qeverisjen e Benito Musolinit. - Analizon politikën e jashtme të Italisë gjatë regjimit fashist.		Fjalët kyçe: Benito Musolini, këmishëzinj, Viktor Emanuel, fashizmi, lëvizja fashiste, partia nacional-fashiste		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, hartë e Evropës dhe botës, foto nga interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Pema e mendjes	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënë	Punë me hartën	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Për realizimin e kësaj faze të orës së mësimi mund të përdoren foto nga interneti të cila kanë lidhje me njëra –tjetrën në lidhje me një ngjarje apo dukuri historike. Nxënësit duhet të arrijnë në përfundime në lidhje me çështjet që do të trajtohen. Kështu në figurën e dhënë si shembull jepet një pamje e ushtrisë fashiste. Nxënësi duhet ta lidhë atë me partinë fashiste

dhe figurën qendrore të saj Benito Musolini. Një rrugë tjetër është ajo e përdorimit të një fjale: p.sh Këmishëzinjtë- nxënësit duhet të zbulojnë cili është kuptimi parë i kësaj fjale.





NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Shkruhet në tabelë nga mësuesi termi Fashizëm. Po kështu shkruhet pyetja: Çfarë forme qeverisëse është fashizmi? Pse lindi fashizmi në Itali? Kush u bë figura udhëheqëse?

Hapi i dytë: Cilat ishin pasojat e fashistëve në pushtet?

Viti 1922- Marshimi mbi Romë. Formimi qeverisë nga Benito Musolini

- Viti 1926- Gjithë partitë e tjera dolën jashtë ligjit.

U realizua partia-shtet

- U krijua policia sekrete
- Indoktrinimi shoqërisë


Besimi, bindje, forcë fizike, ky ishte slogani i fashistëve

Hapi i tretë: Një politikë e jashtme agresive.

1. Politikë autoritare në Ballkan
2. Dominim në Libi dhe Etiopi
3. 1936 Formimi i aksit Romë-Berlin.
4. Filluan pushtimet në Shqipëri 7 Prill 1939
5. Nënshkrimi i “Paktit të Çelikut” Gjermani-Itali

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Në fazën e fundit nxënësit në një hartë të Europës dhe Botës tregojnë vendet që pushtoi Italia.



Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni Informacion: Shqipëria u pushtua nga Italia fashiste në 7 Prill 1939. Kërkoni ilustrime ndonjë link që ju njihni në internet. Vëreni me vëmendje ilustrimet dhe tregoni cilave qytete iu përkasin dhe çfarë mesazhi përcjellin ato.



Gjermania Naziste

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Gjermania Naziste		Situata e të nxënit: Cilat janë regjimet e tjera totalitare sipas jush përveç komunizmit dhe fashizmit? Adolf Hitler, çfarë iu thotë ky emër?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon rreziqet që kërcënonin demokracinë e brishtë të Republikës së Vajmarit. - Pasqyron kushtet që favorizuan ardhjen e Hitlerit në pushtet. - Analizon rrugën që ndoqi Hitleri për ta kthyer Gjermaninë në një diktaturë të ashpër naziste. - Analizon thelbin e regjimit nazist.		Fjalët kyçe: Rajh, Hidenburg, Adolf Hitler, Herman Goering, Ribentrop, Revolucioni legal, shtet racist, antisemit dhe totalitar		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, foto nga interneti të Hitlerit, simbole të nazizmit etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Stuhi Mendimesh	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Punë me grupe	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim idesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit 10'

Për realizimin e kësaj faze të orës së mësimi mund të përdoren foto nga interneti të cila kanë lidhje me njëra –tjetrën në lidhje me një ngjarje apo dukuri historike. Shkruhet në tabelë tema e mësimi. Mësuesi mund të zgjedhë për të punuar për shpjegimin përmes fjalës ose fotove të caktuara si p.sh, portretet e Adolf Hitlerit, portrete të esesve apo pamje të kryqit të thyer nazist.



NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Klasa ndahet në grupe dhe brenda grupit secili prej nxënësve ka një tjetër numër përfaqësues që shkon në varësi të numrit të nxënësve. Këshillojmë që grupi të mos jetë më i madh se 4-5 nxënës. Çfarë detyrash do të realizojnë grupet? Detyrat në zbatimin e kësaj metode janë të njëjta. Duke qenë e njëjta detyrë, do të shohim se shkëmbimi mendimeve dhe ballafaqimi i tyre është më i realizueshëm.

Detyrat për çdo grup

- Si u krijua Republika e Vajmarit dhe cilat ishin vështirësitë me të cilat u përball?
 - Cilin grupim shoqëror përfaqësonte Hitleri?
 - Çfarë përfaqësonte programi i Hitlerit?
 - Çfarë ndihmoi në ardhjen në pushtet të Adolf Hitlerit dhe qeverisë naziste?
 - Cilat ishin politikat që ndoqën nazistët gjatë kohës që ishin në pushtet?
- Përgjigjet e pyetjeve për çdo grup evidentohen në tabelë dhe diskutohen në klasë.



PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit 10'

Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të nxjerrin përfundime, që mësuesi/ ja i konsideron të rëndësishme, p.sh: Cilat ishin rreziqet që e kërcënonin demokracinë e brishtë të Republikës së Vajmarit? Cilat ishin tiparet e qeverisjes së Adolf Hitlerit? Cili ishte thelbi i regjimit nazist?

Vlerësimi

Vlerësim individual ndërnxënës i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: Adolf Hitler (1889-1945). Në ç'mënyrë ideologjia naziste dhe veprimtaria e tij ndikoi në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore të Gjermanisë, në periudhën midis dy luftërave botërore?

**Amerikanët besojnë në demokraci**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Amerikanët besojnë në demokraci		Situata e të nxënës: Në cilin bllok luftimesh ishte rreshtuar SHBA gjatë Luftë I? Si e përfytyroni situatën në SHBA pas luftës?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon format e racizmit në SHBA. - Përshkruan thelbin e ekonomisë së konsumit masiv. - Përshkruan mënyrën e ardhjes në pushtet të Ruzvelt. - Analizon thelbin e politikës së Ruzvelt për ekonominë. - Argumenton sukseset e politikës së Ruzvelt në ekonomi, kulturë dhe shoqëri.		Fjalët kyçe: Ekonomi e konsumit masiv, Huver, Ruzvelt, Ku Klus Klan		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Fletore shënimesh		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës.	Parashtrim me terma paraprakë	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Shënime të strukturuar	Punë me tekstin, mbajtje shënimesh	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Organizues grafik i informacionit	Diskutim përfundimesh, Paraqitje grafike e informacionit	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi prezanton temën me anë të situatës së të nxënës për të diskutuar rreth situatës së SHBA pas Luftës së I. **NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'**

Pas kësaj nxënësit ndahen në 4grupe, ku secili merr një detyrë të veçantë. Detyrat sipas grupeve janë:

- Interesat amerikane kanë përparësi
- SHBA në krizë, fundi i ëndrrës amerikane
- Kursi i Ri i Ruzveltit
- Rezultatet e New Deal: suksesi në politikë, shoqëri dhe në kulturë.

Pas marrjes së detyrave nxënësit punojnë me çështjet përkatëse në tekst duke mbajtur shënime në fletore.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Ndërkohë mësuesi organizon në dërrasë një organizues grafik, që do plotësohet me kontributin e grupeve.

AMERIKANËT BESOJNË NË DEMOKRACI			
Interesat amerikane kanë përparësi	SHBA në krizë	Kursi i Ri i Ruzvelt	Rezultatet e New Deal

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Formuloni përfundimet tuaja për Ku Klus Klan

Kapitalizmi dhe demokracia nuk u lëkundën në Britani

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Kapitalizmi dhe demokracia nuk u lëkundën në Britani	Situata e të Nxënit: Britania e Madhe renditet si një ndër shtetet më të zhvilluara sot. Çfarë dini ju për këtë vend?			
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Identifikon mënyrën sipas të cilës Britania ruan pozitën ndërkombëtare të saj. - Tregon rrugën nëpër të cilën krijohet Komonuellthi Britanik. - Përshkruan rrugën që ndjek Britania për të kapërcyer krizën. - Analizon format e progresit ekonomik në Britani. - Analizon mirëqenien sociale e cila ndikoi në forcimin e institucioneve politike.	Fjalët kyçe: Pozitë ndërkombëtare, Komonuellthi Britanik			
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, harta e Britanisë së Madhe, foto nga interneti	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Parashikim me terma paraprakë	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Punë në grupe	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit.	Turi i Galerisë	Ekspozim punimesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi ndërton në tabelë skemën e mëposhtme dhe kërkon nga nxënësit të japin mendimet e tyre. Në këtë skemë paraqiten objekte të njohura që lidhen me historikun e Anglisë. Këto objekte sillen për të drejtuar nxënësit te mësimi i ditës. Pyetjet që lindin nga skema: Cili është shteti që do të flasim sot? Çfarë përfaqëson Anglia si fuqi ekonomike? Kush është roli i mbretëreshës Elizabetë në jetën ekonomike/ politike të Britanisë së Madhe?



Flamuri Anglez



Paundi



Big Ben

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Secili nga grupet do të zbërthejë një prej çështjeve të mësimi. Për të ndihmuar veprimtarinë e nxënësve mësuesi shkruan për secilën çështje disa pyetje.

Grupi i parë: Britania në vitet 1918-1928.

- Cila ishte panorama e Britanisë së Madhe pas Luftës II Botërore?
- Cilët ishin grupimet politike që përfaqësonin jetën politike në vend?

3. Si qeverisej Anglia e kësaj periudhe?

Grupi i dytë: Kriza ekonomike e viteve 1929-1935

1. Cilat ishin disa nga shkaqet kryesore të krizës në Angli?

2. Po pasojat?

Grupi i tretë: Efektshmëria e qeverisjes

1. Pse u krijua qeveria e koalicionit? Cili ishte programi që zbatoi kjo qeveri?

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'

Të gjitha përgjigjet e dhëna nga nxënësit në trajtën e skedave paraqiten në formën e një ekspozite. Mësuesi i fton nxënësit të vizitojnë punimet e njëri-tjetrit dhe të bëjnë vlerësimin e tyre.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Nevil Çamberlen kërkon me çdo kusht një marrëdhënie paqësore me Gjermaninë naziste. Pse?



Franca në mbrojtje të vlerave republikane

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Franca në mbrojtje të vlerave republikane.		Situata e të nxënës: Në cilën aleancë ishte rreshtuar Franca gjatë Luftës së I Botërore? Si e përfytyroni situatën e saj pas lufte?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan karakteristikat e zhvillimit ekonomik të Francës në vitet 1920-1930. - Tregon veçoritë e krizës në Francë. - Analizon pasojat e krizës në Francë në aspektin ekonomik, politik e shoqëror. - Evidenton rolin e Frontit Popullor në Francë gjatë krizës së republikës. - Analizon shkaqet që çuan në dështimin e qeverisjes së Frontit Popullor në Francë.		Fjalët kyçe: Puankare, Front Popullor, Leon Blumi, Daladier.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i historisë, Interneti, fletore, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës	Diskutim i njohurive paraprake	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Organizues grafik i informacionit	Shënime/ Diskutime, Paraqitje grafike e informacionit	20'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës	Shkrim i shkurtër	Punë me shkrim	15'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi/ ja prezanton temën me anë të situatës së të nxënës dhe disa për të cilat tërhiqen njohuritë e nxënësve, që shënohen në dërrasë. Nxënësit shprehin secili nga një ide që evidentohet në dërrasë. Disa nga konceptet mund të jenë: Krizë Ekonomike, Reforma Sociale etj.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 20'

Nxënësit pasi shprehin gjithçka që dinë, fillojnë studimin e tekstit duke mbajtur shënime dhe diskutuar me njëri-tjetrin. Pyetjet që lindin gjatë studimit dhe nuk marrin përgjigje nga diskutimi me shokun i drejtohen mësuesit që i evidenton në dërrasë dhe i shtron për diskutim me gjithë klasën. Disa nga lidhjet kryesore të koncepteve organizohen në një kllaster në tabelë, prej mësuesit dhe plotësohen me kontributin e nxënësve.



PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit 15'

Nxënësit realizojnë një punim me shkrim me temë: “Klasa e mesme ndiheshë e sigurt me qëndrueshmërinë e institucioneve të demokracisë liberale”. Pse klasa e mesme e një shoqërie është e rëndësishme për demokracinë?

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Përshkruani reformat e qeverisë së Frontit Popullor. Diskutoni, cilat reforma për ju kishin ndikim pozitiv në shoqëri?



Jetë paralele: Franklin Ruzvelt

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Jetë paralele: Franklin Ruzvelt		Situata e të nxënës: Disa emra historikë frymëzojnë energji të pashembullta për të punuar për jetën e njerëzimit, siç është ajo e liderit demokrat amerikan Franklin Ruzvelt. Edhe pse në kushte të vështira shëndetësore, qenia e tij punoi për të lumturuar miliona njerëz në Amerikë dhe në mbarë botën në periudhat më famëkeqe të njerëzimit atë të Krizës së Madhe Ekonomike 1929-1933 dhe Luftës së II. F. Ruzvelt nuk kishte lindur një demokrat i dhënë pas lumturisë që sjell jeta, por ai u bë një i tillë. Zbulojeni jetën dhe rrugën që e çoi Ruzveltin në luftë për të siguruar paqe dhe ekuilibër botëror.		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon disa momente biografike të jetës së F. Ruzvelt. - Rendit shkallët që e çuan F. Ruzvelt drejt presidencës. - Analizon thelbin e Kursit të Ri të Franklin Ruzvelt - Përshkruan rrjedhjat e sulmit japonez në Pearl Harbour. - Analizon rëndësinë e figurës së F. Ruzvelt për historinë e SHBA.		Fjalët kyçe: Ruzvelt, Pearl Harbour		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti historisë, harta e SHBA, foto nga interneti etj.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit	Kllaster	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar	Punë me grupe	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënësit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'

Mësuesi/ ja prezanton temën me anë të situatës së të nxënësit dhe disa për të cilat tërhiqen njohuritë e nxënësve, që shënohen në dërrasë. Nxënësit shprehin secili nga një ide që evidentohet në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Mësuesi ndërton në tabelën e mëposhtme në dërrasën e zezë. Për të udhëhequr nxënësit në punën e tyre jepen konceptet në të djathtë dhe kërkohet që gjatë leximit nxënësi të bëjë një shpjegim të shkurtër me fjalët e tij. Këshillojmë që kjo tabelë të përgatitet në Power Point dhe të jetë e shoqëruar me foto dhe materiale të tjera ndihmëse ilustruese. Më pas mësuesi plotëson shpjegimin me ato koncepte të cilat nxënësit nuk arrijnë t'i pasqyrojnë qartë dhe saktë.

KONCEPT	SHPJEGIMI
Mrekullia Amerikane 1920 -1928 Faktorët	Prodhimi i përgjithshëm u dyfishua. Rritja e nivelit të jetesës Prodhimi mbi bazën e linjave lëvizëse të montimit. Rritja e kërkesës së konsumatorëve. Përdorimi kredive. Shfrytëzimi reklamave.

Kriza ekonomike 1929- 1939 Faktorët	Rënia e prodhimit/mbyllja e fabrikave. Rënia e nivelit të jetesës/ shfaqja e problemeve sociale. Prodhimi nuk u bë në përpjesëtim të drejtë me konsumin. Shpërndarja e pasurisë ishte e pabarabartë.
Franklin Ruzvelt 30 janar 1932-12 prill 1945 Franklin Ruzvelt 30 janar 1932-12 prill 1945	Mori postin e presidentit si përfaqësues i Partisë Demokratike më 1932. • Shpalli programin që e quajti “Kursi i Ri”. Rishtë: • Rritja e rolit të shtetit e të institucioneve të tij në jetën ekonomike. • Shteti mori përsipër ndërtimin e veprave publike. • Shteti u bë punëdhënësi për të papunët. • U rrit prodhimi sipërmarrjeve private. • U vendosën lidhje të qëndrueshme mes punësimit/konsumit. • Legjislacioni social: sigurime shoqërore/ paga minimale/ java e punës 40 orë. PËRFUNDIMI: U vendosën bazat e shtetit social

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Për realizimin e kësaj rubrike mësuesi shfrytëzon tekstin duke punuar rubrikën me pyetje në fund të saj. Nxirren përfundime në lidhje me rëndësinë e F. Ruzvelt si president i SHBA.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur: Analizoni shprehjen e Ruzvelt : <i>“E vetmja gjë që ne kemi frikë është vetë frika”</i>



Jetë paralele: Adolf Hitler

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Jetë paralele: Adolf Hitler		Situata e të Nxënës: Disa emra historikë frymëzojnë neveri të tillë të menjëhershme dhe të theksuar siç është ai i udhëheqësit nazist Adolf Hitler. Duart e tij u ngjyrosën me gjakun e miliona njerëzve që vrau gjatë Luftës së II sidomos atyre të hebrenjve. Hitleri nuk lindi tiran brutal ai u bë i tillë. Zbuloheni jetën dhe rrugën që e çoi Hitleri në shkatërrimin e jetëve njerëzore.		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon disa momente biografike të jetës së Adolf Hitlerit. - Përshkruan cilësitë vetjake të tij. - Pasqyron idetë e tij dhe vizionin politik në librin “Main Kampf” - Evidenton mënyrën se si e përballoi Krizën Ekonomike qeveria hitleriane. - Analizon qeverisjen e Hitlerit. - Argumenton arsyet që çuan në rënien e nazizmit në Gjermani.		Fjalët kyçe: Adolf Hitler, lideri historik nazist që frymëzon neveri.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë	Pyetja sjell pyetjen	Analizë informacioni	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Pyetja sjell pyetjen	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënë	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Duke pasur parasysh që nxënësit kanë informacion paraprak për temën, mësuesi përgatit një sërë pyetjesh “pse”, që lidhen me të duke servirur njëkohësisht fakte të reja nga ana e tij. P.sh disa nga pyetjet e drejtuara mund të ishin: Cila ishte rruga që ndoqi A.Hitler për të ardhur në pushtet? Nga buronte urrejtja e tij për hebrenjtë? Pse figura e tij konsiderohet kaq famëkeqe për historinë e njerëzimit? etj

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësit orientohen të punojnë me tekstin në mënyrë të tillë që të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të shtrura, kështu ata thellohen të analizojnë e gjejnë shkaqe. Përveç pyetjeve të shkruara nga mësuesi, nxënësit nxiten të krijojnë pyetje shkakore që ua drejtojnë shokut të bankës, pasi janë punuar në dyshe. Pyetjet e drejtuara ndaj njëri-tjetrit i detyrojnë nxënësit t'i rikthehen informacionit për një studim më të thellë. Në këtë mënyrë ata arrijnë të gjejnë të gjitha lidhjet shkak-pasojë që lidhen me burimin e urrejtjes së Hitlerit ndaj hebrenjve dhe vrasjet antinjerëzore ndaj tyre.


PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënë 10'

Të gjitha përfundimet që nxënësit nxorën diskutohen në klasë, duke u bërë kujdes i veçantë nga mësuesi që në klasë të prezantohen edhe përfundimet për pyetjet “pse” të krijuara nga vetë nxënësit.

Vlerësimi:
Ndërkohë që nxënësit punojnë, mësuesi gjen kohën për të bërë një vlerësim të parë të dosjeve të nxënësve, pasi gjatë gjithë kapitullit nxënësit kanë realizuar detyra të shumta të cilat duhet të vlerësohen.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Përshkruani vizionin politik të Hitlerit dhe mënyrën se si e vuri në zbatim atë. Cili është qëndrimi juaj për të?


Jetë paralele: Josif Stalin

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Jetë paralele: Josif Stalin		Situata e të nxënë: Disa emra historikë frymëzojnë neveri të tillë të menjëhershme dhe të theksuar siç është ai i liderit komunist J.V Stalin. Duart e tij janë të ngjyrosur me gjakun e miliona të vvarëve, gjatë e pas Luftës së Dytë Botërore. Stalini nuk lindi tiran ai u bë i tillë. Zbuloheni jetën dhe rrugën që çoi Stalinin në shkatërrimin e jetëve të njerëzve.		
Rezultatet e të nxënë të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon disa momente të fëmijërisë së hershme të J. V. Stalin. - Përshkruan fillimet e aktivitetit politik të tij. - Identifikon mënyrën se si ai erdhi në pushtet si udhëheqës i vetëm. - Analizon reformat ekonomike dhe politike të tij. - Argumenton arsyet se pse kjo figurë historike ka ende mbështetës në Rusi.		Fjalët kyçe: J.V Stalin, dogmë		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti, fletore shënimesh, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat e tjera shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë	Parashikim	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	VMLD(Veprimtari me lexim të drejtuar)	Lexim/ diskutim/ shënime	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënë	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Mësuesi prezanton temën e mësimit me anë të situatës së të nxënë, duke iu drejtua nxënësve me pyetje të tilla si: Çfarë dini ju për Josif Stalin liderin diktator të ish Bashkimit Sovjetik? Po për komunizmin si sistem totalitar çfarë mund të thoni? Me anë të këtyre pyetjeve ata mundohen të parashikojnë se për çfarë bën fjalë tema e re. Idetë e nxënësve pranohen nga mësuesi.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Mësuesi/ ja orienton nxënësit të lexojnë pjesën paragraf pas paragrafi, duke nxjerrë ato koncepte që u duken thelbësore për temën e duke bërë krahasime edhe me parashikimin e bërë nga vetë nxënësit, në diskutim me shokun e bankës.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënë 10'

Në këtë fazë nxënësit reflektojnë lidhur me atë që kuptuan nga paragrafët e lexuar duke nxjerrë përfundime për pyetje/ çështje të tilla si: Cila ishte fëmijëria e hershme e J.V Stalin? Cilat ishin fillimet e aktivitetit politik të tij? Si u bë ai udhëheqës i Partisë Komuniste? Cilat janë tiparet e personalitetit të Stalinit? Cilat ishin reformat që ai ndërmori në ekonomi dhe në politikë? Çfarë ndodhi pas vdekjes së tij? Përfundimet më të rëndësishme të tyre shënohen në tabelë.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimit dhe mësuesi dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Pyetni më të rriturit që kanë jetuar në periudhën komuniste në Shqipëri, a e kanë njohur një "reformë" të tillë si kjo e Stalinit në Shqipëri? Stalini zbatoi një regjim terrori duke i arrestuar njerëzit për t'i vënë para gjyqeve të hapura.



Bota në vitet 1920-1939 Demokraci apo totalitarizëm?

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedis dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Bota në vitet 1920-1939 Demokraci apo totalitarizëm?	Situata e të Nxënë: Në temat paraardhëse ne kemi diskutuar për forma qeverisjeje si demokracia dhe totalitarizmi. Cilat janë vendet ku janë zbatuar këto forma dhe cilat janë tiparet e tyre?			
Rezultatet e të nxënë të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston sistemet politike kryesore të qeverisjes. - Krahason këto sisteme politike midis tyre. - Përshkruan shkaqet e triumfit të qeverisjeve totalitare në vitet 1920-1939. - Analizon tiparet e qeverisjes së demokracisë liberale dhe rëndësinë e saj.	Fjalët kyçe: Qeverisje demokratike liberale, qeverisje totalitare.			
Burimet / Mjetet / Materialet: teksti historisë, hartë e Evropës dhe botës, interneti	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u , Gjeografia			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit	Stuhi mendimesh	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Ditari tri pjesësh	Punë me grupe/ mbajtje shënimesh	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Lapsat në mes	Punë me klasën/ përfundime	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Në trajtën e një brainstorming nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore dhe njohuritë e orëve të kaluara që lidhen me format e qeverisjes si Komunizëm dhe Demokraci. Pas kësaj nxënësit njihen me natyrën e punës që do kryejnë.

KONCEPTI	SHPJEGIMI	KOMENTI
Prirjet ekonomike	Rimëkëmbja pas Luftës së Parë Botërore, në mënyrë të veçantë e ShBA. Faktorët që çuan në rritjen progresive të prodhimit: • Mospërfillja e kërkesave të konsumatorit nga kapitali. • Zhvillimi i kapitalizmit liberal. Fenomeni i krizës botërore -1929-1933	Kjo u pasqyruar me krijimin e shumë degëve të reja të industrisë dhe prodhimit të mallrave të reja. Kjo solli rënien e nivelit të jetesës. Zhvillimi tregut u bazua në mekanizmat e tij: konkurrencë, ofertë/ kërkesë. Shkaktoi papunësi.
Prirjet politike	Sistemi i demokracisë liberale. U praktikua në ShBA, Angli, shtetet Skandinave. Përgjegjësitë e shteteve ku zbatohet demokracia liberale: - Miratimi ligjeve të reja për sigurimet sociale. - Garantimi pagës minimale si siguri për jetesën.	Këto shtetet për shkak të këtij sistemi e patën më të thjeshtë kalimin e krizës. Të gjitha këto ishin të lidhura me Shtetin e Mirëqenies Sociale.
KONCEPTI	SHPJEGIMI	KOMENTI
Totalitarizmi	Përfaqëson sundimin total të shtetit dhe ka dy forma qeverisëse: komunizmin dhe fashizmin. Tiparet e totalitarizmit : - Partia unike. - Ideologjia unike. - Kult i udhëheqësit (një individ). - Nënshtrimi individit ndaj shtetit. - Terrori dhe frika masive.	Është i kundërt në prirje me demokracinë liberale. Regjimet komuniste ishin të rrezikshëm për zhvillimin ekonomik/ politik të vendit. Pengonin pronën private/ të drejtat e individit etj. Dallimi mes totalitarizmit komunist dhe fashist qëndron në raport me pronën.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Synimi i përdorimit të kësaj teknike është përfshirja e të gjithë nxënësve në veprimtari. Secili prej tyre duhet të gjejë një fjalë ose në rastin më të mirë edhe një ide. Në momentin që janë të gatshëm ta thonë një të tillë, atëherë ngrihen e thonë dhe lapsi vendoset në tryezën e mësuesit. Kjo veprimtari ka për qëllim edhe rritjen e vëmendjes/ kujdesit ndaj përgjigjes së shokut. Pasi ka përfunduar dorëzimi i të gjithë lapsave, mësuesi kalon në fazën e dytë. Tashmë nxënësit duhet të tregojnë se cili qe fjala/ideja e shokut që ka lënë në tavolinën e punës së mësuesit lapsin X.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, punën me ilustrimet fotot e tekstit dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Listoni



Veprimtari praktike: Ballkani në periudhën midis dy luftërave Botërore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Ballkani në periudhën midis dy luftërave Botërore		Situata e të nxënit: Në periudhën midis dy luftërave botërore, vendet e Ballkanit kishin probleme të trashëguara nga e kaluara. Në shumicën e tyre ishin vendosur diktaturat e krahut të djathtë të prirura për antisemitizëm. Kështu që ato kishin përkrahje të konsiderueshme nga Hitleri. Megjithatë shqetësimi kryesor i çdo kombi ishte të ruante pavarësinë e fituar me vështirësi. Por, shpërthimi i Luftës së II Botërore, e bëri të pamundur për të arritur këtë.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Identifikon tiparet e jetës politike shoqërore në Ballkan në periudhën midis dy luftërave. - Shqyrton informacione në mënyrë të drejtë. - Zhvillon aftësitë e tij hulumtuese. - Analizon veçanërisht situatën në Shqipëri në periudhën midis dy luftërave. - Fitojnë aftësi në kërkim historik. - Fitojnë njohuri mbi tiparet e jetës politike dhe shoqërore në Ballkan në periudhën midis dy luftërave.		Fjalët kyçe: Anti-semitizëm		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara.

1. Situata në Shqipëri në periudhën midis dy luftërave.
2. Gjendja ekonomike dhe shoqërore në periudhën midis dy luftërave në Greqi
3. Gjendja ekonomike shoqërore në periudhën midis dy luftërave në Bullgari.
4. Shkaqet që çuan në probleme etnike në Ballkan.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Ballkan midis dy luftërave Botërore. Me fotot, hartat e gjetura nxënësit krijojnë një album, poster, power point, ese duke evidentuar sidomos gjendjen e Shqipërisë në periudhën midis dy luftërave.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Situata në Shqipëri në periudhën midis dy luftërave.

Grupi II:

Gjendja ekonomike dhe shoqërore në periudhën midis dy luftërave në Greqi

Grupi III:

Gjendja ekonomike shoqërore në periudhën midis dy luftërave në Bullgari.

Shkaqet që çuan në probleme etnike në Ballkan.

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësim në grup për punën e kryer.

Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nuk parashikohen



Ekonomia në periudhën pas Luftës I Botërore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Ekonomia në periudhën pas Luftës I Botërore		Situata e të nxënës: Ju keni dëgjuar firma të ndryshme makinash si Ford apo General Motors. Ku prodhohen këto makina? Si mendoni ju si do të ishte situata ekonomike në Britani, Francë dhe SHBA pas Luftës së I?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon zhvillimet ekonomike në SHBA, Britani dhe Francë pas Luftës së Parë Botërore. - Përshkruan zhvillimet ekonomike në Rusi, Itali dhe Gjermani pas Luftës së I Botërore. - Krahason zhvillimin ekonomik midis këtyre vendeve. - Analizon ndikimet e zhvillimeve ekonomike në shoqëri dhe jetën e njerëzve.		Fjalët kyçe: Komunizëm i luftës, NEP, bumi ekonomik		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-, Ekonomia, Gjeografia, Filozofia		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim i ideve	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar/ Organizues grafik i informacionit	Lexim ndërveprues/ shënime/ paraqitje grafike e informacionit	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënës	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi/ ja prezanton temën me anë të situatës së të nxënës, e cila nxit nxënësit të shprehin gjithkçka që dinë rreth temës nga përvojat e tyre dhe leximet e mëparshme. Idetë e tyre evidentohen në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj nxënës lexojnë në dyshe, lexojnë duke mbajtur shënime e duke krahasuar atë që parashikuan dhe dinin me atë që po lexojnë. Në këtë mënyrë saktësojnë konceptet paraprake. Nxënës organizojnë në fletore nga një organizues grafik, duke konsideruar të gjitha marrëdhëniet me konceptin “dhe”. Çdo dyshe nxënësish duhet të paraqesë një organizues grafik pak a shumë si ai i mëposhtëm.

EKONOMIA PAS LUFTËS SË I BOTËRORE					
SHBA	Britania e Madhe	Francë	Rusi	Itali	Gjermani
-ekonomi liberale	-teknologji e vjetruar në fabrika	1920-1930 zhvillim të lartë ekonomik	-komunizmi i luftës- shtetëzim	-ekonomi e dobët	-dëmshpërblimi për aleatët
-bum ekonomik	-rendiment i ulët	-prodhim autoveturash	-1921-1922 pllakos uria	-tri betejat –për tokën-për drithin-e liritës	1923-zhvlerësohet paraja
-ekonomi konsumi	-vështirësi ekonomike	-qeveria forcon buxhetin	-NEP-politikë e re ekonomike	-mungesë burimesh për zhvillim të bujqësisë	-investime publike
-industria e makinave	-reforma, përmirësim i situatës	-klasa e mesme e sigurt	-Lenin-përmirësoi situatën	-importe të larta	1924-1929 vita të arta

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Në këtë fazë nxënësit reflektojnë lidhur me atë që kuptuan nga leximi duke nxjerrë përfundime për pyetje të tilla si: Cilat janë zhvillimet ekonomike në SHBA, Britani e Francë pas Luftës së I botërore? Cilat janë zhvillimet ekonomike në Gjermani, Itali e Rusi pas Luftës së I botërore? Krahasojini ato etj . Përfundimet e tyre evodentohen në organizuesin grafik të ndërtuar në fazën e ndërtimit të njohurive.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë për saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: <i>Cili ishte zhvillimi ekonomik i Shqipërisë pas Luftës së Parë Botërore?</i>



Kriza Ekonomike Botërore 1929-1933

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Kriza Ekonomike Botërore 1929-1933		Situata e të nxënës: Kur përmendim togfjalëshin “Krizë Ekonomike Botërore” çfarë iu vjen ndërmend?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston shkaqet e Krizës Ekonomike Botërore - Evidenton pasojat e kësaj krizë - Tregon shtetet që u prekën më së shumti nga kjo krizë. - Analizon pasojat shoqërore në fushën shoqërore dhe politike.		Fjalët kyçe: Aksione, Depresion i Madh, depozita bankare, Huver		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, foto nga interneti, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat e tjera shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës	Stuhi mendimesh	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Përvijim i të menduarit	Studim teksti/ Krijim i përvijimit të të menduarit	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënës	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënëit 10'

Pasi prezantohet tema me anë të situatës së të nxënëit, mësuesi/ ja u tregon foto të njerëzve gjatë viteve të krizës për të krijuar një Stuhi Mendimesh tek ata. Idetë e nxënësve diskutohen në klasë.



SHBA, shoqëria në protestë kundër papunësisë



Gjatë krizës në SHBA

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Mësuesi ngjall diskutime me anë të fotove të paraqitura, ndërkohë që nxënësit krijojnë përvijimin e të menduarit, të cilin e plotësojnë dhe e shtojnë me fjalë e koncepte që i njohin që më parë ose i lexojnë në tekst, duke punuar në dyshe ose grupe të vogla. Në këtë mënyrë nxënësit kanë krijuar hartën e tyre të, mendjes që ka si karakteristikë të kuptuarin e lidhjeve sipas tyre.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënëit 10'

Në këtë fazë nxënësit kanë krijuar përvijimet e tyre të të menduarit janë gati të diskutojnë për pyetje që u drejton mësuesi. Përfundimet më të arrira të dala nga ky diskutim evidentohen në dërrasë nga mësuesi.

Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur: Kërkoni Informacion: A e preku Shqipërinë Kriza Ekonomike Botërore? Në ç'mënyrë shfaqet kriza ekonomike?



Politikat Kombëtare për të dalë nga Kriza

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Politikat Kombëtare për të dalë nga Kriza		Situata e të Nxënëit: Termat Kursi i Ri dhe Ekonomi e komanduar nuk janë të rinj për ju. Çfarë iu vjen ndërmend kur i dëgjoni?		
Rezultatet e të nxënëit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon "gabimet" e presidentit Huver në zgjidhjen e Krizës. - Përshkruan rrugën që ndoqi Rusvelt për të bërë zgjidhjen e pjesshme të krizës. - Analizon mënyrën se si arriti të ruante pozitat ekonomike Britania. - Analizon përpjekjet e vendeve totalitare për të dalë nga kriza.		Fjalët kyçe: Ekonomi tregu, Kursi i Ri i Ruzvelt, ekonomi e komanduar, nacionalizim.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, interneti, fletoret, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat e tjera shoqërore		

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'

Mësuesi në këtë fazë e parashtron temën e re me anë të situatës së të nxënësit, përgjigjet e nxënësve evidentohen në tabelë. Diskutohen njohuritë e tyre të kaluara në lidhje me politikat e F. Ruzvelt për të rimëkëmbur ekonominë amerikane si dhe për “ekonominë komuniste” ruse.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Kjo mundëson që nxënësit të kalojnë në fazën e diskutimit në dyshe për atë që panë, por edhe për atë që janë duke lexuar në tekst. Në mënyrë që konceptet dhe lidhjet midis tyre të dalin sa më të qarta ata orientohen që gjatë punës të mbajnë shënime sipas një skeme të sugjeruar nga mësuesi. Mësuesi sugjeron që t'i kushtohet rëndësi e veçantë të dallimeve midis situatës së krizës në vendet e Europës Perëndimore me ato totalitare.



PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënësit 10'

Të gjitha përfundimet që nxënësit nxorën diskutohen në klasë, duke u bërë kujdes i veçantë nga mësuesi që në klasë të prezantohen edhe përfundimet për pyetjet e dala gjatë diskutimit duke konkluduar sidomos për të përbashkëtat dhe dallimet e vendeve totalitare me ato demokratike në kapërcimin e krizës.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen

Veprimtari praktike: Monarkia Shqiptare dhe Kriza Botërore.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Monarkia Shqiptare dhe Kriza Botërore.		Situata e të nxënësit: Në periudhën midis dy luftërave botërore Shqipëria përballej me probleme të trashëguara nga e kaluara. Në vitet 1929-1933, vitet e Depresionit të Madh, vendi qeverisej nga Mbreti Zogu I. Ekonomia shqiptare në këtë kohë ishte e lidhur dhe e ndërvuar ngushtësisht me ekonominë italiane, më një sërë paktesh dhe marrëveshjesh. Ju do të zgjidhni problemin si u prek Shqipëria nga kriza? Si e përballoi Monarkia Shqiptare atë?		
Rezultatet e të nxënësit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Identifikon politikat e Monarkisë për të dalë nga kriza. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Shkruan një raport mbi masat e marra nga Monarkia për të dalë nga kriza. - Fitojnë aftësi në kërkimin historik. - Fitojnë njohuri mbi tiparet e jetës politike dhe shoqërore në Ballkan në periudhën midis dy luftërave.		Fjalët kyçe: Monarkia Shqiptare, Ahmet Zogu		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Shqipëri gjatë viteve të Monarkisë. Me fotot, hartat e gjetura nxënësit krijojnë një album, poster, power point, ese duke evidentuar sidomos gjendjen e Shqipërisë në vitet e Krizës Botërore.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Situata në Shqipëri në vitet e Krizës Ekonomike Botërore 1929-1933.

Grupi II:

Rruga që ndoqi qeveria e Ahmet Zogut për të përballuar krizën

Grupi III:

Tiparet e qeverisjes monarkike të Ahmet Zogut

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer.
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Shoqëria në vitet 1920-1939

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Shoqëria në vitet 1920-1939	Situata e të nxënësve: Ç'kuptoni me termat : industrializim dhe urbanizim? Shprehni lirshëm mendimet tuaja.			
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Pasqyron karakteristikat e shoqërisë me qeverisje demokratike liberale. - Pasqyron karakteristikat e shoqërisë me qeverisje totalitare. - Krahason këto karakteristika me ato të vendeve totalitare.	Fjalët kyçe: Urbanizim, industrializim, demokratizim, Çikago, Londër, Coca-Cola, Çeka, Gestapo, luftën e klasës, nomenklaturë.			
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti, foto të ndryshme, tabela, fletore shënimesh	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar	Mbajtje shënimesh/ Diskutim	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi në këtë fazë e parashtron temën e re me anë të situatës së të nxënit, përgjigjet e nxënësve evidentohen në tabelë. Disa nga pyetjet që u drejtohen nxënësve janë: Çfarë dini ju për Coca-Cola? Po për mënyrën e jetesës së amerikanëve? Mendimet e shumicës së nxënësve evidentohen në tabelë.



NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësve u sugjerohet nga mësuesi informacioni që duhet lexuar në tekst duke i nxitur të mbajnë shënime, të mendojnë, reflektojnë e të nxjerrin përfundime, duke diskutuar me shokun e bankës, mësuesin, për të saktësuar konceptet e marrë përgjigje për pyetjet që lindin. Të gjitha veprimtaritë e lart përmendura bëhen për ti dhënë përgjigje pyetjes: Cilat janë tiparet e shoqërisë në vendet demokratike dhe ato totalitare në vitet 1920-1939? Përfundimet e nxjerra diskutohen para klasës dhe evidentohen në dërrasë nga nxënësit.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Në këtë fazë nxënësit konkludojnë rreth diskutimit të zhvilluar në fazën e ndërtimit të njohurive duke arritur në përfundimin se: ***Ekulibri shoqëror është siguria e një shoqërie për paqe.***

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, ndërnxënës i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Lidheni me Shqipërinë: Çfarë forme të qeverisjes kishte Shqipëria në vitet 1920-1939?



Shoqëria në vitet 1920-1939

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Shkenca dhe Teknologjia		Situata e të Nxënit: Emrat: Albert Ajnshtajn; Çarli Çaplin; Sigmund Frojd nuk janë të panjohur për ju. Çfarë iu vjen ndërmend kur i dëgjoni ata?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon zhvillimet teknologjike të ndodhura në vitet 1920-1939. - Evidenton mënyrën se si ndikuan këto arritje në zhvillimin e shoqërisë. - Liston dy risitë në fushën e shkencës. - Përshkruan thelbin e këtyre risive. - Analizon rëndësinë e këtyre arritjeve.		Fjalët kyçe: Albert Ajnshtajn, Çarls Lindbergh, Hollivud, Çarli Çaplin, Teoria e Relativitetit, Sigmund Frojd.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, interneti, foto të ndryshme, Fizika		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Fizika, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënëit	Stuhi mendimesh	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Marrëdhëniet pyetje-përgjigje	Studim i thelluar i tekstit, diskutim	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënëit	Harta e koncepteve	Organizim grafik i informacionit	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënëit 10'


Mësuesi/ ja pasi prezanton temën me anë të situatës së të nxënëit, liston në dërrasë një varg pyetjesh një kategori që merr përgjigje në tekst dhe një tjetër që merr përgjigje nga njohuritë dhe mendimet e nxënësve. Nxënësit mbajnë shënime për pyetjet e shtruara.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj ata bëjnë një studim të tekstit, duke i dhënë përgjigje në fletore pyetjeve të shtruara, sipas mundësisë. Mësuesi në mënyrë të shpejtë teston klasën se në çmasë ka gjetur zgjidhje për pyetjet e shtruara. Për pyetjet që nuk marrin përgjigje nga nxënësit, mësuesi jep vetë zgjidhje.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënëit 10'

Konceptet dhe lidhjet midis tyre organizohen në një hartë konceptesh në dërrasë, të sugjeruar dhe plotësuar me kontributin e nxënësve.



Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, ndërnxënës i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: për jetëshkrimin e Albert Ajnshtajn dhe Sigmund Frojd. Cilën cilësi të karakterit të tyre do të donit të kishit ose jo?



Arti dhe Kultura

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Arti dhe Kultura		Situata e të Nxënëit: Kur dëgjoni emrat: Pablo Pikaso, Zhan Pol Sarter, surrelizëm, ekzistencializëm çfarë iu vjen ndërmend?		
Rezultatet e të nxënëit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon ndryshimet kulturore në botën e pas luftës. - Përshkruan mënyrën se si ndryshoi kultura nën ndikimin e komunikimit masiv. - Pasqyron karakteristikat e artit dhe kulturës në vitet 1920-1939 - Analizon rrymat e reja që lindën në pikturë, muzikë, letërsi dhe filozofi.		Fjalët kyçe: Surrealizmi, ekzistencializmi, kubizmi, Zhan Pol Sarter, Margaret Sanger, Pablo Pikaso, Kibizmi, Ema Goldman, Amelia Earhart.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, interneti, fletore shënimesh, tabela, vepra të realizmit, piktura abstraksionist.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat e tjera shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë	Diskutim	Bashkëbisedim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Harta e të menduarit	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Punë e pavarur	Diskutim përfundimesh	10'


PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Kjo fazë realizohet me ndihmën e tekstit duke përdorur fotot ilustruese ose me foto nga interneti në klasat ku disponohet. Mësuesi drejton pyetjen: Duke shikuar figurat (në tekst/ ose të zgjedhura nga ai vetë në internet) çfarë mendimesh ju lindin? Shënohen në tabelë përgjigjet e mundshme.

1. Objekt i mësimin të sotëm do të jetë arti dhe kultura.
2. Elementet arkitekturore janë të ndikuar nga moderniteti.
3. Zhvillimet kulturore/ letrare/ artet figurative ju kundërvunë pasojave të luftës.
4. Lindën gjini të reja në letërsi dhe pikturë

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Mësuesi paraqet për ilustrim portrete shkrimtarësh, vepra apo piktura të piktorëve të njohur. Pyet nxënësit nëse i kanë ndeshur më parë. Nëse po në çfarë rrethanash? Si shembull ne kemi marrë një pikturë të Pikasos.



PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Punohet fillimisht me pjesëmarrjen e gjithë klasës rubrika e tekstit Përcakto. Në këtë rubrikë janë dhënë prirjet kulturore, letrare dhe në artet figurative. Nxënësi plotëson kolonën tjetër me arritjet/ përmbushjet. Përgjigjet duhet të jenë të shkurtra dhe mund të zgjerohen me gojë. Në këtë fazë mësuesi bën vlerësim të disa përgjigjeve.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Cili është shkrimtari më i njohur i viteve '30? Cili është mesazhi i veprës së tij. Gjetjet diskutojini në klasë.



Veprimtari Praktike: Shoqëria shqiptare në vitet '30 përmes filmit koncert në vitin '36

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Veprimtari Praktike: Shoqëria shqiptare në vitet '30 përmes filmit koncert në vitin '36		Situata e të Nxënës: Cilat ishin karakteristikat e jetës shqiptare në vitet 1918-1939?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë shqiptare, krahasuar me shoqëritë totalitare të kësaj periudhe. - Diskuton mbi karakteristikat e artit dhe të kulturës shqiptare në vitet '30 - Vlerëson rolin që kanë luajtur në art figura të tilla si: Tefta Tashko Koço. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: Tefte Tashko Koço, Koncert në vitin 1936.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Shqipëri në vitet '30. Ata shikojnë filmin Koncert në vitin 1936 tri herë dhe mbajnë shënime për qeverisjen, shoqërinë dhe këngëtarin në skeda të vogla. Punimet e tyre paraqiten në trajte eseje, poster apo power point.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Jeta e Tefta Tashko Koços

Grupi II:

Koha kur u prodhua filmi dhe qëllimi i tij

Grupi III:

Shqyrtim i të dhënave të grumbulluara dhe konkluzione mbi shoqërinë shqiptare në vitet '30.

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzioneesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:	Detyrat dhe puna e pavarur:
Vlerësim në grup për punën e kryer.	Nuk parashikohen
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.	



Përsëritje: Lufta dhe Paqja; Sistemet politike; Ekonomia; Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca 1920-1939

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Përsëritje: Lufta dhe Paqja; Sistemet politike; Ekonomia; Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca 1920-1939		Situata e të nxënit: Ju tashmë keni marrë përgjigje rreth shumë pyetjeve të shtrura këtë kapitull. Proveni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton mbi shkaqet e fillimit të luftës së dytë botërore. - Përshkruan zhvillimet ushtarake dhe politike gjatë luftës së parë botërore. - Tregon vendimet e Konferencës së Paqes. - Evidenton thelbin e Revolucionit Bolshevik. - Analizon vendosjen e fashizmit në Itali. - Analizon vendosjen e nazizmit në Gjermani. - Pasqyron tiparet e demokracisë në Athinë. - Analizon tiparet e totalitarizmit gjatë qeverisjes së Adolf Hitlerit, Benito Musolinit dhe Josif Stalin. - Argumenton reformat e Rusvelt në SHBA “Kursi i Ri”. - Pasqyron gjëndjet e vendeve europiane dhe SHBA gjatë viteve të Krizës Ekonomike Botërore (1929-1933) - Liston arritjet më të rëndësishme në Teknologji dhe Kulturë. - Formon shprehje bashkëpunimi. - Mëson të vlerësojë kontributin anëtarëve të grupit.		Fjalët kyçe: Aleancë Tripalëshe, Aleancë e Antantës, Revolucion Bolshevik, Vladimir Iliç Lenin, Udro Uillson, Konferenca e Paqes, Lidhja e Kombeve, Josif Lenin, Marksizëm, Benito Musolini, fashizëm, nazizëm, Adolf Hitler, Kursi i Ri, Ekonomi i konsumit masiv, Komuellth Britanik, Leon Blumi, Pearl Harbour, Franklin Ruzvelt, totalitarizëm, Depresion i Madh.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Parashikim (Stuhi Mendimesh)	Diskutim idesh	5'
FAZA II	Harta e Koncepteve të kapitullit	Organizim grafik i informacionit	20'
FAZA III	Diskutim	Diskutim përfundimesh	20'

FAZA I: 5min

Ora fillon me prezantimin e çështjeve për diskutim, të sugjeruara nga nxënësit. Pas kësaj mësuesi u propozon të organizojnë në fletore një pemë konceptesh në bazë të kriterit të lidhjeve të ngjarjeve. Në mënyrë të shpejtë nxënësit evidentojnë disa nga lidhjet që arrijnë të dallojnë.

FAZA II: 20min

Klasa ndahet në disa grupe me të njëjtën detyrë: organizimi i pemës së koncepteve të kapitullit, çdo anëtar i grupit sugjeron lidhje dhe kontribuon në shtimin e “degëve” të pemës. Pema e mundshme e ndonjërit prej grupeve mund të ishte:



FAZA III: 20min

Pas kësaj secili nga grupet marrin detyra specifike, të cilat i deklarojnë të zgjidhura para klasës. Secili nga nxënësit teston veten me pyetjet për përsëritje që gjenden në tekst.

Vlerësimi:
Vetëvlerësim, Vlerësim i përgjigjeve me gojë, vlerësim i aftësisë për të punuar individualisht dhe në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Testim: Lufta dhe Paqja; Sistemet politike; Ekonomia; Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca 1920-1939

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Testim: Lufta dhe Paqja; Sistemet politike; Ekonomia; Shoqëria, arti, kultura dhe shkenca 1920-1939		Situata e të Nxënit: Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbledhës që është i detyrueshëm në fund të çdo tremujori.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përdor informacionin në mënyrën e duhur - Seleksionon informacionin sipas nevojës. - Analizon situatë e lidhje të ndryshme - Demonstron aftësi për të krahasuar. - Demonstron aftësi për të interpretuar. - Shpreh aftësi për të nxjerrë përfundime. - Formon shprehje të punës së pavarur. - Mëson të shprehë formimin me shkrim		Fjalët kyçe: Përshkrim, analizë, vlerësim, interpretim, përfundime		
Burimet / Mjetet / Materialet: Fleta e testit në të njëjtin format për çdo nxënës		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS**FAZA I: 5min**

Mësuesi orienton nxënësit lidhur me kërkesat e formatit të testit dhe shpërndan testet.

FAZA II: 40min

Nxënësit marrin testin që është unik dhe punojnë gjatë gjithë orës.

FAZA III: 5min (nga koha e pushimit)

Sapo bie zilha testet mblidhen dhe janë objekt i vlerësimit të vazhduar.

SRUKTURA E MËSIMIT: TJETËR

Pyetjet për testim nga: Bashkimi Europian dhe Prirjet e Qytetërimeve sot.

Rretho alternativën e saktë.

1. Në Aleancën trepalëshe bënin pjesë:

- a) Itali, Gjermani, Rusi
- b) Britani, Francë, SHBA
- c) Itali, Britani, Francë
- d) Francë, Gjermani, Rusi

2. Lufta I Botërore filloi në vitin

- a) 1914
- b) 1915
- c) 1916
- d) 1917

3. Lidhja e Kombeve u krijua në:

- a) Konferencën e Versajës
- b) Konferencën e Londrës
- c) Konferencën e Potsdamit
- d) Konferencën e Jaltës

4. Iniciatori i Revolucionit Bolshevik në Rusi ishte:

- a) Josif Stalin
- b) Vladimir Iliç Lenin
- c) Cari Nikolla II
- d) Mikael Gorbaçov

5. Adolf Hitleri erdhi në pushtet me anë të:

- a) Dhunës
- b) Zgjedhjeve Elektorale
- c) Propagandës
- d) Grushtit të shtetit

6. Prona shtetërore ishte në themel të regjimit:

- a) Fashist
- b) Komunist
- c) Nazist
- d) Demokrat

7. Pearl Harbour ishte bazë ushtarake amerikane në Paqësor, e cila u sulmua nga:

- a) Japonia
- b) Gjermania
- c) Italia
- d) Rusia

8. Thelbi i Kursit të ri të Franklin Rusvelt ishte:

- a) Përdorimi i fuqisë së qeverisë për të rindërtuar ekonominë
- b) Përdorimi i fuqisë së qeverisë për të mbajtur pushtetin me forcë
- c) Shtetëzimi i ekonomisë dhe i pronës
- d) U zbatua Bashkimi Sovjetik

9. Kultura sunduese në botë në shek. XX ishte ajo:

- a) Amerikane
- b) Sovjetike
- c) Gjermane
- d) Italiane

10. Kriza ekonomike botërore ndodhi gjatë viteve:

- a) 1929-1933
- b) 1928-1930
- c) 1929-1932
- d) 1929-1931

11. Identifiko shkaqet e dy luftërave botërore.

12. Trego blloqet kryesore ushtarake në prag të luftërave.

13. Përshkruaj pasojat ekonomike, sociale dhe psikologjike të dy luftërave botërore.
14. Vlerëso rëndësinë e Lidhjes së Kombeve.
15. Listo tiparet e sistemeve kryesore politike në vitet 1920-1939.
16. Evidento pasojat e krizës së vitit 1929-1933.
17. Analizo politikat që ndërmorën Anglia, Franca dhe SHBA për të dalë nga kriza ekonomike.
18. Analizo ndryshimet ndërmjet tipareve të shoqërive totalitare me ato të shoqërive demokratike.
19. Analizo dhe gjyko pasojat e holokaustit.
- 20-Analizo karakteristikat e artit dhe kulturës në vitet 1920-1939.

Vlerësimi: Vlerësim individual për secilin. Vlerësim përmblledhës **Detyrat dhe punë e pavarur:** Nuk parashikohen



Ecuria e botës drejt luftës

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Ecuria e botës drejt luftës.		Situata e të Nxënës: Traktati i Versajës mori disa vendime në lidhje me Gjermaninë, cilat ishin këto vendime? Çfarë pasojash kishin ato për Gjermaninë?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon territoret që pushtuan Italia, Gjermania dhe Japonia për të zgjeruar perandoritë e tyre duke pushtuar kombe të tjerë. - Rendit shkaqet e shpërthimit të Luftës së II Botërore. - Liston arsyet se pse Bota po shkonte drejt luftës në vitet '30. - Analizon luftën civile në Spanjë si pararendëse e fillimit të Luftës së Dytë Botërore. - Analizon politikat e diktatorëve që e çuan botën drejt Luftës së Dytë Botërore.		Fjalët kyçe: Guernika, Luftë Civile, Franko Daladier, Çamberlein.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, interneti, fletore shënimesh, tabela		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkenca të tjera shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Diskutim	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënësit	Skema	Shpjegim skemash	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'

Mësuesi/ja prezanton temën dhe shkruan në dërrasë disa koncepte nga tema, si p.sh “Traktati Versajës”, “Gjermania Naziste”, Adolf Hitler, Luftë e Dytë Botërore, për të cilat nxënësit, të japin përcaktime dhe të gjejnë lidhje midis tyre. Të gjithë nxënësit japin idetë e tyre për konceptet, të cilat shënohen në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj për të qartësuar idetë e nxënësit orientohen të studiojnë tekstin, të evidentojnë konceptet e panjohura dhe të përpunin t'i sqarojnë ato në diskutim me shokun/ shoqen e bankës. Pyetjet që nuk arrijnë të marrin përgjigje i adresohen mësuesit dhe shpjegohen prej tij.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Në këtë fazë nxënësit me anë të ndërtimit të skemave të thjeshta, shpjegojnë arsyet që çuan në fillimin e Luftës së Dytë Botërore.

Shkaqet e fillimit të Luftës së II Botërore	1. Shkelja e Traktatit të Versajës dhe Paktit të Lidhjes së Kombeve nga Gjermania, Italia dhe Japonia.
	2. Vendosja e diktaturës fashiste në Itali 1922. Pushtimet i filloi me Etiopinë dhe Shqipërinë.
	3. Vendosja e diktaturës naziste në Gjermani. Bëri aneksimin e Austrisë dhe Çekosllovakisë.
	4. Kriza Ekonomike 1929-1933 lulëzoi anarkinë.
	5. Ekspansioni japonez dhe pushtimi i Kinës 1937.
	6. Antikomunizmi. Frika se komunizmi mund të përhapej në botë bën të mundur që shtetet e Boshtit Qendror, të nënshkruajnë Paktin Antikomunist.
	7. Politika e mosndërhyrjes e fuqive të Aleatëve Perëndimorë p.sh i lanë dorë të lirë nazistëve gjermanë dhe italianë të pushtonin vende europiane.

Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Pse themi që diktatorët e çuan botën drejt Luftës?



Lufta e II Botërore, Frontet Kryesore

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Lufta e II Botërore, Frontet Kryesore		Situata e të nxënës: Çfarë dini ju për Luftën e II Botërore? Koalicionet dhe taktikat e luftimeve?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Evidenton ngjarjen që konsiderohet si akti që shënoi fillimin e Luftës së II Botërore. - Liston arsyet se pse gjermanët nuk arritën të pushtojnë Britaninë? - Tregon arsyet se pse Gjermania e sulmoi BRSS. - Pasqyron frontet kryesore të luftës. - Përshkruan kur lufta merr karakter botëror. - Analizon arsyet se pse beteja e Stalingradit u bë pikë kthese e luftës. - Analizon përfundimin e luftës së II Botërore.		Fjalët kyçe: Luftë e çuditshme, vija Mazhino, Stalingrad, Ushtria e kuqe, Pearl Harbour, Truman, Hiroshima, Nagasaki.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti, fletore, tabela e zezë, harta historike.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Gjeografia.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim i ideve	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar/ Organizues grafik i informacionit	Lexim ndëreveprues/ shënime/ paraqitje grafike e informacionit	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënës	Skemë	Plotësim skeme	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënëit 10'

Nxënësve u tregohen disa foto të ngjarjeve gjatë Luftës së II Botërore. Duke u nisur nga fotot nxënësit shprehin gjithçka që dinë lidhur me to. Të gjitha idetë e tyre shënohen në dërrasë.



Sulmi japonez mbi Pearl Harbor, 7 dhjetor 1941




Hitleri pushtoi Parisin, 22 qershor 1940



Bomba atomike hidhet mbi Hiroshima dhe Nagasaki, përkatësisht në 6 dhe 9 gusht 1945

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'


Pas kësaj nxënësit, në dyshe, lexojë duke mbajtur shënime e duke krahasuar atë që parashikuan dhe dinin me atë që po lexojnë. Në këtë mënyrë saktësohen konceptet paraprake. Nxënësit organizojnë në fletoret e punës nga një organizues grafik, duke konsideruar të gjitha marrëdhëniet me konceptin “denudim”. Çdo dyshe nxënësish duhet të paraqesë një organizues grafik pak a shumë si ai i mëposhtëm.



Ky organizues paraqitet edhe në dërrasë dhe plotësohet me sugjerimet e nxënësve të cilët tashmë kanë punuar me një të tillë.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënëit 10'

Në këtë fazë nxënësit identifikojnë në hartën historike frontet e luftës dhe betejat e zhvilluara në Europë dhe në botë gjatë Luftës së II Botërore.



Vlerësimi:

Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: Lidheni me Shqipërinë gjatë Luftës së II Botërore. Cili ishte pozicioni i Shqipërisë përballë dy blloqeve gjatë Luftës së II Botërore.



Fundi i Luftës, një botë e rrënuar.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Fundi i Luftës, një botë e rrënuar.		Situata e të Nxënit: Lidhur nga njohuritë e temës së kaluar. Si e mendoni botën pas Luftës së II Botërore?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan pasojat sociale, ekonomike dhe morale të Luftës II Botërore. - Evidenton arsyet se pse ekonomia e SHBA u bë më e fuqishme edhe pse hyri në luftë. - Pasqyron situatën në vendet me ekonomi më të rrënuar. - Analizon luftën ndaj hebrenjve që zhvilloi Adolf Hitler. - Analizon marrëdhëniet midis shteteve pas përfundimit të Luftës së II Botërore.		Fjalët kyçe: Aushvic, Bukenvaid, Treblinka, Mathauzen, Nuremberg, holokaust, kampe përqëndrimi, gjenocid.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Interneti, fletore, tabela e zezë, harta historike, gjeografike.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit	Diskutim i njohurive paraprake	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Mbajtja e strukturuar e shënimeve	Studim teksti/Diskutim shënimesh	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Situata e të nxënit i lejon nxënësve të shprehin gjithçka dinë lidhur me temën. Idetë më të arrira të tyre evidentohen në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Në fazën II, nxënësit ndahen në 2 grupe të mëdha, për efekt detyre, por punojnë në dyshe dhe orientohen të lexojnë paragrafët përkatës, duke mbajtur shënime të strukturuar sipas mësuesit në dërrasë.

Grupi I gjatë studimit të tekstit i strukturon shënimet si më poshtë.

Pasojat e Luftës së II Botërore	1.Humbje njerëzore 50Milionë njerëz të vdekur.
	2.Shkatërrim i industrisë dhe rënie e prodhimit.
	3.Rënie e rolit të Europës.
	4.Krime kundër njerëzimit, pasoja morale.
	5.Vrasje ndaj popullsisë hebreje në kampet e përqendrimit.

Grupi II

Me përfundimin e Luftës së II Botërore	1.Përfundoi koha e Europës si fuqi ekonomike dhe politike.
	2.SHBA u bënë superfuqi.
	3.U përhap komunizmi jashtë kufijve të Europës dhe BS u ngrit në rolin e superfuqisë.
	4.Filloi Lufta e Ftohtë.
	5.Filloi koha e Luftës Bërthamore.
	6.U rrit nacionalizmi dhe lëvizja për pavarësi në Azi dhe Afrikë.
	7.U rinjoh mbështetja e organizmave që luftojnë për paqen si OKB etj.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Në fund bëhen disa komente nga vetë mësuesi dhe disa pyetje të përgjithshme si: Cilat ishit pasojat në njerëz të Luftës së II Botërore? Po pasojat në ekonomi? Çfarë ndodhi në skenën politike botërore pas përfundimit të Luftës së II Botërore? Në rast të nxënësit kanë pyetje që ia drejtojnë mësuesit ai/ajo i jep përgjigje.

Vlerësimi:
Vlerësim individual, i detyrave të shtëpisë të dhëna orën e kaluar, vlerësim ndërnxënës.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Gjyqet në Shqipëri pas luftës së II Botërore. Cilat janë? Pse? Shkruani opinionin tuaj.



Projekt Kërkimor: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. (Shkëmbime ndërpersonale) Ora e dytë e projektit.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Projekt Kërkimor: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. (Shkëmbime ndërpersonale) Ora e dytë e projektit.		Situata e të Nxënës: Ju tashmë e dini se ç'përfaqësojnë projektet. Paraqitni mënyrës e punës që keni ndjekur deri në këtë fazë të projektit.		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Demonstron pasuri idesh - Shpreh dëshirë për të bashkëpunuar - Fiton shprehje për tu organizuar - Identifikon vendndodhjen e kampeve shfarosëse naziste në Europë. - Lexon dhe shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Shkruan një raport, ese, krijon një poster, ekspozitë, album që tregon kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve në orën e tretë të projektit.		Fjalët kyçe: Projekt kurrikular, miniprojekt, rezultate të nxënës gjatë projektit, burime, mjedis pune etj.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Historia 8, Historia 9, Mediat, Interneti, Literaturë historike, Bibliotekat		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkencat shoqërore, TIK-u		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Diskutim	Diskutim i ideve	10'
FAZA II	Zgjidhje problemesh	Mbajtje shënimesh	25'
FAZA III	Diskutim	Diskutim i ideve	10'

FAZA I: 10min

Në mënyrë të shpejtë nxënësit veç e veç ose në dyshe prezantojnë informacionin e mbledhur para shokëve dhe mësuesit/ es në vija të përgjithshme.

FAZA II: 25min

Në këtë fazë nxënësit pasi kanë marrë sugjerime nga shokët dhe mësuesi për atë që prezantuan, reflektojnë individualisht ose në dyshe lidhur me seleksionimin e materialit ose strukturimin e projektit. Ndërkohë ata qartësojnë me ndihmën e mësuesit, gjithçka të paqartë që lidhet me miniprojektin e tyre.

FAZA III: 10min

Pas kësaj ata janë të hapur të diskutojnë lidhur me miniprojektin e tyre edhe me shokët që i përkasin grupeve të ndryshme. Në këtë mënyrë, projekti merr formë përfundimtare.

Vlerësimi:
Vlerësim individual për secilin, për fazën përkatëse të punës.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Përgatitja e projektit deri në fazën përfundimtare.



Projekt Kërkimor: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. (Shkëmbime ndërpersonale) Ora e tretë e projektit

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha:Mjedisi dhe shoqëria	Lënda:Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Projekt Kërkimor: Kontributi i shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. (Shkëmbime ndërpersonale) Ora e tretë e projektit		Situata e të Nxënit: Ju tashmë e dini se ç'përfaqësojnë projektet. Paraqitni mënyrës e punës që keni ndjekur deri në këtë fazë të projektit.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Demonstron pasuri idesh - Shpreh dëshirë për të bashkëpunuar - Fiton shprehje për tu organizuar - Identifikon vendndodhjen e kampeve shfarosëse naziste në Europë. - Lexon dhe shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Shkruan një raport, ese, krijon një poster, ekspozitë, album që tregon kontributin e shqiptarëve në mbrojtjen e hebrenjve në orën e tretë të projektit.		Fjalët kyçe: Projekt kurrikular, miniprojekt, rezultate të nxëni gjatë projektit, burime, mjedis pune, strukturim, seleksionim, prezantim, burime, shkëmbime ndërpersonale.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Historia 8, Historia 9, Mediat, Interneti, Literaturë historike, Bibliotekat		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Shkencat shoqërore, TIK-u		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Diskutim	Diskutim i ideve	10'
FAZA II	Punë me grupe	Punë me grupe	25'
FAZA III	Diskutim	Diskutim i ideve	10'

FAZA I: 10min

Në mënyrë të shpejtë nxënësit veç e veç ose në dyshe prezantojnë informacionin e mbledhur para shokëve dhe mësuesit/ es në vija të përgjithshme.

FAZA II: 25min

- Grupi I-Në hartën e Shqipërisë, shënon vendet, ku ka gjetur dëshmi që tregojnë se shqiptarët kanë mbrojtur hebrenjtë.
- Grupi II- Në hartën e Europës, shënon kampet e përqendrimit të ngritura nga nazistët.
- Grupi III-përzgjedh fotot dhe dokumente të shkruara, më domethënëse të qëndrimit të shqiptarëve në mbrojtje të hebrenjve.

FAZA III:10min

Pas kësaj ata janë të hapur të diskutojnë lidhur me miniprojektin e tyre edhe me shokët që i përkasin grupeve të ndryshme. Ata vendosin së në ç'mënyrë do të bëjnë paraqitjen e projektit të tyre poster, power point, ese, album, raport ose ekspozitë.

Vlerësimi:
Vlerësim individual për secilin, për fazën përkatëse të punës.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Përgatitja e projektit deri në fazën përfundimtare (Ruajtja e materialeve)

**REZULTATET E TË NXËNIT ME KOMPETENCA
QYTERËRIMET E SOTME BASHKËKOHORE (1945-SOT)**

NXËNËSI:

- Përshkruan karakterin dhe qëllimet e OKB
- Vlerëson rolin e Planit Marshall në rindërtimin e Europës.
- Përshkruan shkaqet e Luftës së Ftohtë dhe krijimin e blloqeve ushtarak.
- Përshkruan tiparet kryesore të organizimit ekonomik politik të shteteve perëndimore dhe lindore.
- Shpjegon arsyet dhe rrugët drejt integrimit ekonomik politik të shteteve të bllokut perëndimor.
- Përshkruan tiparet kryesore të organizimit ekonomiko-politik të shteteve të bllokut komunist.
- Evidenton arsyet e bumit ekonomik në shtetet e bllokut perëndimor.
- Përshkruan prirjet e Revolucionit të III Industrial.
- Përshkruan mënyrën e jetesës në Europë 1945-1990
- Shqyrton lëvizjet sociale në Europë dhe SHBa duke vlerësuar arritjet e tyre.
- Tregon tiparet e reja në art, kulturë, shkencë, arsim në Europën e viteve 1945-1990
- Përshkruan ngjarjet që shënuar përfundimin e Luftës së Ftohtë
- Përcakton lëvizjet antikomuniste që transformuan shtetet komuniste në shoqëri demokratike
- Identifikon në hartën politike të Europës ndryshimet territoriale të pas Luftës së Ftohtë.
- Vlerëson rolin dhe rëndësinë e Bashkimit Europian
- Vlerëson zgjerimin e procesit të integrimit euro-atlantik në shtetet ish-komuniste të Europës Qendrore dhe Lindore.
- Vlerëson integrimin rajonal si proces ndihmës i integrimit europian.
- Evidenton lëvizjet e reja sociale.
- Përcakton ndryshimet që solli në jetën ekonomike dhe shoqërore Revolucionin i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit.
- Diskuton kuptimin e ndotjes së mjedisit.
- Evidenton efektet e globalizimit.
- Përshkruan format dhe mënyrat e ndryshme të jetesës në qytetërimet e sotme, duke gjykuar mbi raportet trashëgimi dhe tendencat e reja sot.
- Vlerëson tiparet dhe prirjet e reja të artit, kulturës dhe arsimit
- Vlerëson prirjet e zhvillimit të shkencës dhe të teknologjisë drejt zbulimit të kozmosit, modernizimit dhe automatizimit të jetës.



Përpyekjet për të vendosur paqen

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Përpyekjet për të vendosur paqen.		Situata e të Nxënës: OKB-është një organizatë e rëndësishme ndërkombëtare, ç'mund të thoni për të?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon dy konferencat e mëdha ndërkombëtare që përcaktuan fatin e Europës. - Liston vendimet e Konferencës së Paqes në Paris. - Përshkruan funksionimin e OKB-së dhe organet e saj. - Argumenton rolin e OKB-së në ruajtjen e paqes në botë.		Fjalët kyçe: Jaltë, Potsdam, Gjykata Ndërkombëtare, Paris, Konferenca e Potsdamit, Paris, Konferenca e Paqes në Paris, OKB.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës	Kontroll frontal	Pyetje-përgjigje	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Dora e fshehtë	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënës	Rrjeti i diskutimit	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi i drejton klasës disa pyetje që ngacmojnë njohuritë e marra gjatë orëve të mëparshme.

- Kur përfundoi Lufta e Dytë Botërore?

- Cilat ishin shtetet fituese të saj?

- Cilat ishin pasojat e Luftës?

- Kujtoni disa veprime të rëndësishme diplomatike të arritura gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Pas kësaj mësuesi bën lidhjen me temën e re me anë të situatës së të nxënës.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Klasa ndahet në tri grupe aq sa janë edhe çështjet mësimore. Përpara realizimit të veprimtarisë pjesëtarët e grupit duhet të mësojnë shumë mirë mësimin për veten e tyre e më pas të provojnë t'ua tregojnë shokëve.

Grupi I: Lufta e Dytë Botërore

• Cilat ishin pasojat e L.II.B? Pasojat e Luftës së Dytë Botërore ishin më të rënda se ato të Luftës së Parë Botërore.

• Krimet e luftës ishin kundër njerëzimit, pasojat e hedhjes së bombave atomike në Hiroshimë dhe Nagasaki.

• U krijuan qendra të posaçme për shfarosjet masive si p.sh kampe përqendrimi, pune si Aushvic, Mathauzen etj.

• Si pasojë e Holokausti u zhdukën rreth 6.5 milionë hebrenj, ku 1.5 milionë ishin fëmijë.

• Për të vënë në vend drejtësinë u organizua gjyqi i Nurembergut (20 Nëntor 1945)

Grupi II: Traktatet e Paqes

• Pse lindi e nevojshme në kontekstin historik dhe politik të nënshkruheshin traktate paqeje?

• Nënshkrimi i traktateve ishte në funksion të paqes (Konferenca e Potsdamit korrik-Gusht 1945)

• 2 Korrik 1946 u mbledhën 22 shtete. Traktatet u nënshkruan me : Italinë, Rumaninë, Bullgarinë, Hungarinë e Finlandën.

• Traktatet vendosën për ndryshim territoriale: Konferenca e Jaltës 4-11 Shkurt 1945

• Traktatet vendosën kufizime ushtarake; Elementi më i rëndësishëm i traktateve ishte dëmshpërblimi.

Grupi III: Krijimi OKB

• Si lindi OKB? U krijua si një organizatë garantuese e sigurisë dhe paqes.

• U krijua në San Francisko në konferencën që zhvilloi punimet prill –qershor 1945.

• Karta si dokumenti bazë i OKB me këto parime:

- Njohja dhe respektimi i sovranitetit kombëtar të kombeve-shtete;
- e drejta e kombeve për vetëvendosje;
- zgjidhja e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare e ndërmjet shteteve me mjete paqësore;

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënës 10'

Diskutohen përfundimet përkatëse në lidhje me njohuritë e sapomarra duke u bazuar në pyetjet: A mendoni se krijimi i OKB-së ishte domosdoshmëri pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore. Si mendoni se i ka përmbushur ky organizëm detyrat e tij.

Vlerësimi:
Vlerësim i nxënësit për pjesëmarrje aktive në etapat e mësimdhënies e mësimnxënies, për punën me ilustrimet, punën me hartën dhe saktësinë e përgjigjeve të dhëna.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Argumentoni opinionin tuaj për këtë frazë: “ <i>Diskutimet për paqen janë të vështira, asnjëherë të pamundura apo të përfunduara tërësisht</i> ”


Veprimtari Praktike: Shqipëria anëtare e OKB-së

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Veprimtari Praktike: Shqipëria anëtare e OKB-së	Situata e të Nxënës: Çfarë dini ju për OKB-në?			
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: • Diskuton mbi rrugën që ndoqi Shqipëria për tu bërë anëtare e OKB-së. • Tregon arsyet për shkak të cilave SHBA përkrahën çështjen shqiptare. • Vlerëson rëndësinë që ka për Shqipërinë anëtarësimi në OKB. • Paqyron me anë të fotove aktivitetet bashkëpunuese të Shqipërisë me OKB dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë si ONP, FAO, UNDP. • Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. • Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: OKB, ONP, FAO, UNDP		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min
Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:
Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë rrugën që ka ndjekur Shqipëria për tu bërë anëtare e OKB-së. Punimet e tyre paraqiten në trajte eseje, poster apo power point.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Anëtarësimi i Shqipërisë në OKB, ONP, FAO, UNDP.

Grupi II:

Nënë Tereza Gusht 1975-Medalja Ceres nga FAO (Rëndësia)

Grupi III:

Sa e rëndësishme ka qenë për Shqipërinë anëtarësimi në Lidhjen e Kombeve dhe në OKB.

FAZA III:10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer.
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



SHBA ndihmon Europën

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: SHBA ndihmon Europën		Situata e të nxënit: George Marshall; Harry Truman janë dy figura të rëndësishme në Historinë e Amerikës. Çfarë dini ju për ta?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston faktorët që ndihmuan në rimëkëmbjen e Europës pas Luftës së Dytë Botërore. - Tregon arsyen e krijimit të UNRRA. - Pasqyron motivin se pse SHBA e ndihmoi Europën. - Rendit përparimet teknologjike dhe teknologjike. - Analizon rëndësinë që kishte për Europën ndihma e SHBA-së.		Fjalët kyçe: UNRRA, Plani Marshall.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit	Parashtrim me terma të njohur	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Ditari tre pjesësh	Lexim/ Citime/ Komente	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi/ja bën parashtrimin e temës me terma të njohur. Këtu përdoret edhe situata e të nxënit që i fut nxënësit brenda temës.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësve u jepet pjesa për lexim me kërkesën për të nënvizuar pjesët që u bëjnë më tepër përshtypje pas leximit e nxjerrjes së citimeve të nënvizuara, nxënësve u lihet kohë të bëjnë komente në një tabelë të tipit të mëposhtëm.

Citimet e zgjedhura nga nxënësit	Komentet e nxënësit
Plani Marshall	Programi i ndihmës ekonomike për rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Europës.
Faktorët që ndikuan në rimëkëmbjen e ekonomisë europiane	1. Ndihma e huaj. 2. Ndryshimi i politikave qeveritare ekonomike. 3. Përparimet në shkencë dhe teknologji 4. Rritja e tregtisë botërore.
Përparimet shkencore dhe teknologjike	

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënësit 10'

Në fund bëhen disa komente nga vetë mësuesi dhe disa pyetje të përgjithshme si: Cili ishte ideatori i Planit Marshall? Pse SHBA e ndihmoi Europën për tu rimëkëmbur pas lufte? Cilat ishin përparimet shkencore dhe teknologjike? Në rast se nxënësit kanë pyetje që ia drejtojnë mësuesit/ es ai/ ajo i jep përgjigje.

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Pse UNRRA nuk u lejua të vazhdonte misionin e saj në Shqipëri? Diskutoni gjetjet tuaja në klasë.


Lufta e ftohtë ndan botën.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Lufta e ftohtë ndan botën.	Situata e të nxënësit: Pse SHBA dhe Rusia sot nuk kanë një marrëdhënie të mirë diplomatike? Cili është mendimi juaj?			
Rezultatet e të nxënësit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon arsyet se pse u nda bota në dy kampe. - Përshkruan pasojat e Luftës së Ftohtë. - Analizon mënyrën se si u ulën tensionet në periudhën 1962-1979. - Analizon pasojat e Luftës së Ftohtë ditët e sotme.	Fjalët kyçe: NATO, Blloku Perëndimor, Traktati i Varshavës, Blloku Lindor, KNER, Mao-Ce-Duni, Lufta e Ftohtë, Hrushovi, Kenedi, detanta 1962-1979, Karta e Helsinkit.			
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Lexim i drejtuar	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënësit	Punë me hartën/Shkrim i shkurtër	Punë me hartën	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënësit 10'

Një mënyrë tepër interesante do të ishte fillimi i orës së mësimimit me një pjesë dokumentari mbi Luftën e Ftohtë. Për këtë mund të shfrytëzohen dokumentarët e Explorer ose dhe fragmente dokumentarësh nga interneti. Në pamundësi të këtyre mjeteve mund të paraqiten pamje që tregojnë fillimin e Luftës së Ftohtë.

Mbi foton/ dokumentarin kërkohet të ndërtohet një stuhi mendimi.



Mësuesi pasi dëgjon sugjerimet i drejtohet klasës:

- Cilat shtete mendoni se kanë qenë të përfshira drejtpërsëdrejti në Luftën e Ftohtë?
- Çfarë i shtynte ato në një garë armatimi kaq të fuqishme?

Në përfundim të kësaj faze dhe me dhënien e përgjigjeve jepen nga ana e mësuesit udhëzime për leximin e mësimit të ditës.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Formohen me ndihmën e mësuesit grupet dyshe me nxënësit. Për të realizuar këtë fazë nxënësit ndjekin etapat e mëposhtme:

Etapa I. Puno – të dy nxënësit lexojnë mësimin.

Etapa II. Kupto- të dy nxënësit kuptojnë përmbajtjen e mësimit.


Etapa III. Mëso shokun- njëri prej nxënësve merr rolin e mësuesit.

Ndërhyrja e mësuesit: Mësimi i sotëm trajton një dukuritë historike më të njohura të pasluftës përgjatë 50 vjetëve –Luftën e Ftohtë.

Hapi i parë- rrethanat historike

- Përfundimi Luftës II Botërore.

- Dallimet e mëdha mes sistemeve të kundërta: Komunizmit udhëhequr nga BS/ Demokracia liberale e ShBA dhe vendeve të Evropës Perëndimore.



Hapi i dytë – Cilat ishin luftërat vendore që lindën në kuadër të Luftës së Ftohtë?

1950- Lufta e Koresë; 1950-1970 Lufta e Vietnamit, 1961 – kriza e Kubës, 1968 –agresioni mbi Çekosllavakinë, 1979 – pushtimi Afganistanit etj.

Qëllimi luftërave: Ruajtja e zonave të ndikimit.

Hapi i tretë – Cila ishte kostoja e Luftës së Ftohtë në planin ekonomik/ social?

Shpenzimet ushtarake dëmtuan zhvillimin ekonomik dhe social.

Vendet u izoluan nga njëri-tjetri.

U rritën borxhet për shkak të armatimit të tejskajshëm me armët e dëmtimit në masë.

Etapa IV. Nxënësi pasi dëgjon mësuesin jep mendimin e tij. Mund të drejtojë pyetje për problemet e shtruar nga mësuesi.

Etapa V. Nxënësit shkëmbejnë informacione me njëri –tjetrin.

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënësit 10'

Kjo fazë ndahet në disa veprimtari. Këto veprimtari lidhen me nivelin e klasës

1. Punohet me hartën e botës. Ngjyrosen me lapsa me dy ngjyra përkatëse p.sh blu dhe të kuqe vendit që ishin pjesëtarë të Natos dhe vendet që ishin pjesëtarë të Traktatit të Varshavës.

2. Bëhet një përshkrim i shkurtër mbi arsyet e lindjes së Luftës së Ftohtë.

Mësuesi kontrollon kryerjen e detyrave të ngarkuara dhe bën vlerësimin e tyre.

Vlerësimi:

Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Shqipëria u bë anëtare e Traktatit të Varshavës në 1955. Sot ajo është anëtare e NATO-s. Në çmannyrë ndryshojnë situatat e vendit, në të dy rastet, kur shtetarët kanë marrë këto dy vendime?Diskutoni.



Veprimtari Praktike: Shteti Komunist shqiptar gjatë Luftës së Ftohtë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema Mësimore: Veprimtari Praktike: Shteti Komunist shqiptar gjatë Luftës së Ftohtë.		Situata e të Nxënit: Komunizmi në Rusi e kishte një model, nga buroi ai? Ç'dini ju për vitet e komunizmit në Shqipëri?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton vitet e komunizmit në Shqipëri, jeta shoqërore dhe ekonomike. - Tregon arsyet se pse Shqipëria anëtarësohet në Traktatin e Varshavës. - Vlerëson pozicionin e Shqipërisë gjatë Luftës së Ftohtë. - Pasqyron foto që tregojnë marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë. B. Sovjetik dhe Kinën. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: Shtete satelite, Enver Hoxha, Nikita Hrushov, Mao Ce Dun.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Shqipëri gjatë viteve të komunizmit dhe ndikimet e Luftës së Ftohtë në vendin tonë. Punimet e tyre paraqiten në trajte eseje, poster apo power point.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Gjendja ekonomike shoqërore në Shqipëri 1945-1990

Grupi II:

Marrëdhëniet diplomatike të Shqipërisë me Jugosllavinë, Bashkimin Sovjetik dhe Kinën.

Grupi III:

Analizë e shprehjes së Enver Hoxhës: *Bar do të hamë dhe parimet marksiste-leniniste nuk i shkelim....*Dhe vërtet, nuk i shkelti parimetHelenën dhe Kostën i shpalli armiq të popullit dhe i ndau nga babai....por edhe babai i tyre ishte një si Enveri..(Analizë e pjesës në Tekst: Helena dhe Kosta)

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer.
Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Modeli Amerikan

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Modeli Amerikan		Situata e të nxënit: Termet konsum masiv dhe demokraci liberale nuk janë të panjohura për ju. Gjithashtu Microsoft dhe Apple. Çfarë dini ju për këto terma?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon karakteristikat e modelit amerikan - Përshkruan rolin e presidencës dhe Gjykatës së Lartë në SHBA. - Pasqyron mënyrën se si shtetet dhe media shërbejnë për të balancuar pushtetin federal. - Argumentojnë se pse amerikanët i kushtojnë rëndësi sipërmarrjes së lirë. - Analizon disa anë të modelit amerikan që nuk i përmbushin të gjitha premtimet.		Fjalët kyçe: Demokraci liberale, Kongresi, pushteti federal, liritë vendore, Gjykata e Lartë, melting pot, Microsoft, Apple, skandali Watergate, Stiv Xhobs, Martin Luter King, konsumi masiv.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënit	Pyetja sjell pyetjen	Analizë informacioni	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes	Pyetja sjell pyetjen	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: Konsolidimi i të nxënit	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënë 10'

Duke pasur parasysh që nxënësit kanë informacion paraprak për temën, mësuesi përgatit një sërë pyetjesh pse që lidhen me të, duke servitur njëkohësisht fakte të reja nga ana e tij. P.sh disa nga pyetjet e drejtuara mund të ishin: Ç'kuptoni me ekonomi konsumi ? Ç'kuptoni me demokraci liberale? Ç'lidhje kanë me SHBA Microsoft dhe Apple?

NDËRTIMI I NJOHURIVE: Përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësit orientohen të punojnë më tekstin në mënyrë të tillë që të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të shtruar, kështu ata thellohen të analizojë dhe të gjejnë shkaqe. Përveç pyetjeve të shtruar nga mësuesi nxënësi nxiten të krijojnë pyetje shkakore, që ua drejojnë shokut të bankës, pasi janë duke punuar në dyshe. Pyetjet e drejtuara ndaj njëri-tjetrit i detyrojnë nxënësit t'i rikthehen informacionit për një studim më të thelluar, në këtë mënyrë ata arrijnë të gjejnë të gjitha tiparet e demokracisë liberale dhe modelit amerikan

PËRFORCIMI: Konsolidimi i të Nxënit 10'

Të gjitha përfundimet që nxënësit nxorën diskutohen në klasë, duke u bërë kujdes i veçantë nga mësuesi që në klasë të prezantohen edhe përfundimet për pyetjet pse" të krijuara nga vetë nxënësi.

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Ndarjet politike në SHBA, nuk pengojnë mirëkuptimin për çështjet politike dhe ekonomike. Po në Shqipëri si ndodh ? Diskutoni.



Modeli Liberal European

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Modeli Liberal European		Situata e të nxënës: Çfarë ju thotë termi : Shtet i mirëqenies sociale, po Bashkimi European ?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston shkaqet që e shtynë Europën në rrugën e pajtimit dhe bashkëpunimit pas Luftës së II Botërore - Rendit hapat që ndoqi Europa Për krijimin e komunitetit Ekonomik European - Tregon thelbin e Shtetit të Mirëqenies sociale - Analizon se pse në fushën e qarkullimit të lirë të njerëzve, arritjet e BE-së janë më të pakta - Argumenton se pse procesi i Integritetit European la jashtë vendet e Bllokut Lindor		Fjalët kyçe: Shtet i Mirëqenies, KE, KEE		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës.	Parashikim me terma paraprakë	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Imagjinatë e drejtuar	Lexim i shpejtë	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Shkëmbime ndërpersonale	Diskutim	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi prezanton temën më anë të situatës së të nxënës. Pas kësaj sugjeron një nga konceptet kyçe që lidhen me temën, duke i ftuar nxënës të japin idetë që dinë ose marrëdhëniet që kanë me konceptin. P.sh : Koncepti kyç i sugjeruar mund të jetë: Bashkimi European. Pasi çdo nxënës ka gjetur diçka për të thënë rreth konceptit, të cilat janë shënuar në dërrasë, tani kalohet në fazën e dytë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj atyre u sugjerohet paragrafi për tu lexuar duke iu tërhequr vëmendja që gjatë leximit të thellojnë imagjinatën dhe të krahasojnë atë që po lexojnë me atë që kanë përfytyruar.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'

Në momentin që nxënës kanë përfunduar leximin, ata në mënyrë të shpejtë listojnë në dërrasë pyetjet që u kanë dalë nga ballafaqimi i imagjinatës me atë ç'ka lexuan. Këto pyetje marrin përgjigje nga nxënës të tjerë dhe po qe nevoja edhe nga mësuesi

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Cilat janë kushtet që duhet të plotësojë Shqipëria për tu integruar në Bashkimin European?



Modeli Sovjetik dhe përhapja e tij

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Modeli Sovjetik dhe përhapja e tij		Situata e të nxënësve: Duke u nisur nga njohuritë e kaluara, çfarë mund të thoni për tiparet e totalitarizmit dhe regjimit komunist ?		
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon thelbin e Modelit Sovjetik pas vitit 1945 - Evidenton rolin e Partisë Komuniste në Modelin Sovjetik - Rendit karakteristikat që e bënin Bashkimin Sovjetik një shtet totalitar - Pasqyron vendet në të cilat u përhap Modeli Sovjetik - Analizon politikat që ndoqi Bashkimi Sovjetik në Republikat Satelite të tij		Fjalët kyçe: Diktaturë, Boris Pasternak, Nikita Hrushov, HGB, Nomenklaturë, KNER , Vetëadministrimi Jugosllav		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit	Diskutim i njohurive paraprake	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Organizues grafik i informacionit	Shënime, diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit.	Shkrim i shkurtër	Punë me shkrim	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit 10'

Mësuesi prezanton temën me anë të situatës së të nxënësit, me anë të së cilës tërhiqen njohuritë e nxënësve dhe disa prej tyre shënohen në dërrasë. Secili nxënës shpreh nga një ide që e shkruajnë në dërrasë. Konceptet e shënuara mund të ishin: diktaturë, parti komuniste, vetëadministrim.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësit pasi shprehin gjithçka dinë, fillojnë studimin e tekstit duke mbajtur shënime dhe diskutuar me njëri-tjetrin. Pyetjet që lindin gjatë studimit dhe nuk marrin përgjigje nga diskutimi me shokun, i drejtohen mësuesit që i evidenton në dërrasë dhe i shtron për diskutim me gjithë klasën. Disa nga lidhjet kryesore midis koncepteve organizohen në një kllaster në tabelë nga mësuesi dhe plotësohen me kontributin e nxënësve.



Përhapja e modelit sovjetik

PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit 10'

Nxënësit realizojnë një punim me shkrim me temë: A gjeni ndonjë element të totalitarizmit në ditët e sotme ? Argumentoni përgjigjen tuaj.

Disa prej tyre lexohen në klasë, disa të tjera mblidhen dhe vlerësohen si tregues i nivelit të të nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:**Kërkoni informacion:** Pse Partia Komuniste shqiptare i prishi marrëdhëniet me B. Sovjetik?

Veprimtari praktike: Izolimi dhe Bunkerizimi i Shqipërisë 1945-1990

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Izolimi dhe Bunkerizimi i Shqipërisë 1945-1990		Situata e të nxënësve: Cili ishte qëllimi i ndërtimit të bunkerëve në Shqipëri?		
Rezultatet e të nxënësve të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton mbi arsyet e ndërtimit të bunkerëve në Shqipëri gjatë regjimit komunist. - Diskuton mbi izolimin e Shqipërisë në vitet e fundit të regjimit komunist. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: Izolim, bunkerizim, tolloni		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		
FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA	
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'	
FAZA II	Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'	
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'	

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min**Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:****Hapi 1:** Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Shqipëri në vitet 1945-1990. Ata shikojnë bunkerët e ndërtuar në Shqipëri nëpërmjet imazheve. Punimet e tyre zhvillohen në trajtë ese-je me 100 karaktere.

Hapi 2:

Nxënësit marrin si burim informacioni dhe materialet e tekstit në orën e Veprimtarisë Praktike.

- Prezantojnë esetë e tyre me temë "Izolimi dhe bunkerizimi i Shqipërisë (1945-1990)
- Diskutim rreth esëve të lexuara.

FAZA III: 10min

Diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Korrigjime dhe sugjerime për esetë.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësve.

Vlerësimi:

vlerësim individual i nxënësve për esetë e krijuara.

Detyrat dhe puna e pavarur:

nuk parashikohen.



Epoka e një zhvillimi të jashtëzakonshëm ekonomik

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Epoka e një zhvillimi të jashtëzakonshëm ekonomik		Situata e të nxënit: Ç'kuptoni me fjalën Revolucion Industrial ?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon arsyet pse vitet 1945-1973 janë quajtur si periudhat e 30 viteve të lavdishme - Përshkruan mënyrën se si rritja demografike solli zhvillim në ekonomi - Pasqyron karakteristikat e zhvillimit ekonomik të vendeve të modelit perëndimor - Krahason tiparet e ekonomisë të vendeve të Modelit Sovjetik me vendet e Modelit Perëndimor - Argumentoni se pse në vendet kapitaliste liberale, sipërmarrja është kyç i zhvillimit ekonomik		Fjalët kyçe: Vende të industrializuara, ekonomi liberale, sipërmarrje, ekonomi e centralizuar, vende në zhvillim, marketing, publicitet		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Parashikim me terma paraprakë	Diskutim i ideve	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Diskutim	Studim teksti	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit.	Diagram Veni	Organizim grafik i informacionit	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi shkruan në dërrasë 4-5 fjalë kyçe nga ato që lidhen me temën si: ekonomi e centralizuar, ekonomi liberale, revolucion industrial, dhe u kërkon nxënësve që të shpjegojnë termat sipas mendimit të tyre. Për të saktësuar mendimet, nxënësit diskutojnë së pari në dyshe, pastaj e shprehin mendimin para gjithë klasës. Pritshmëria është që pjesa më e madhe e shpjegimeve për konceptet të marrin përgjigje të sakta. Konceptet që nuk u përcaktuan saktë, nënvizohen në dërrasë dhe nxënësit ftohen të studiojnë informacionin e ri në tekst duke u ndalur veçanërisht tek konceptet e paqarta.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Gjatë studimit të informacionit, nxënësit mbajnë shënime për konceptet e paqarta të nënvizuara, por edhe për të tjera që i dalin gjatë studimit. Pas kësaj ata japin përgjigje jo vetëm për to, por edhe për çdo pyetje që mësuesi e sheh me vend për ta drejtuar.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënit 10'

Në këtë fazë, kur konceptet janë qartësuar, realizohet një diagram Veni, për të krahasuar zhvillimin ekonomik të vendeve të Modelit Perëndimor dhe atyre të Modelit Sovjetik. Diagrama paraqitet në dërrasë dhe fletoret e nxënësve dhe secili e plotëson atë. Diagrama e paraqitur në dërrasë plotësohet me kontributin e të gjithë nxënësve.

Modeli perëndimor në ekonomi

Modeli lindor në ekonomi

Nr.	Veçoritë	Të përbashkëtat	Veçoritë

Vlerësimi:

vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Kërkoni informacion: Në ekonominë e Shqipërisë, pas vitit 1945, shteti eliminoi plotësisht sektorin privat të prodhimit. Pse? Diskutoni në klasë.

**Si ndikoni ekonomia në mënyrën e jetesës**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Si ndikoni ekonomia në mënyrën e jetesës		Situata e të nxënës: Volkswagen-Mrekulli ekonomike-Progres. Çfarë iu vjen ndërmend kur dëgjoni këto terma?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon si ndikoi ekonomia në mënyrën e jetesës - Liston karakteristikat e ekonomisë në vendet kapitaliste pas Luftës së II Botërore - Argumenton se pse ndryshon mënyra e konsumit nga një shoqëri në tjetrën. - Analizon pasojat e zhvillimit të shoqërisë së konsumit		Fjalët kyçe: Sektori terciar, shoqëri konsumatore, klasë e mesme, vende në zhvillim, modeli sovjetik i fshatit, revolucion i II bujqësor		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: Përgatitja për të nxënës	Parashtrim me terma paraprakë	Mbajtje shënimesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Shpjegim i përparuar	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'

Mësuesi prezanton temën me termat e njohur, duke shfrytëzuar edhe situatën e të nxënës, duke u ndalur në çështjet kryesore që do të trajtohen. Ndërkohë nxënësit mbajnë shënime për çështjet që do të trajtohen.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj atyre u kërkohet që për çështjet e parashtruara, në diskutim me njëri-tjetrin të bëjnë një listë për atë që dinë sipas çështjeve. Pasi nxënësit evidentojnë në listat e tyre gjithçka që dinë, mësuesja shpjegon çështjet njëra pas tjetrës, duke drejtuar pyetjet: Cilat janë tiparet e ekonomisë kapitaliste, ç'gjëra të përbashkëta gjeni midis listave tuaja dhe atyre që u përmendën në shpjegim? Ç'të reja mësuat? Gjithashtu nxënësit i drejtojnë mësueses pyetje për paqartësi.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'

Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të nxjerrin përfundimet që mësuesi i konsideron të rëndësishme, si p.sh:

- 1- Punëtorët përbejnë shumicën e fuqisë aktive
- 2- Shoqëria e konsumit në vendet e industrializuara
- 3- Ekonomia transformon botën e punës

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Pyesni gjyshërit: Si keni jetuar ju në kohën tuaj? Diskutoni në klasë gjetjet tuaja



Veprimtari praktike: Jeta e përditshme gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Veprimtari praktike: Jeta e përditshme gjatë regjimit komunist në Shqipëri.		Situata e të nxënës: Cilat ishin karakteristikat e jetës shqiptare në vitet 1945-1990?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton mbi tiparet social-kulturore të shoqërisë shqiptare gjatë regjimit komunist. - Diskuton mbi thelbin e “njeriut të ri” që synonte të krijonte Enver Hoxha. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: Njeriu i ri, armiq të popullit, kudhra		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Prezantim	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Prezantim	Prezantim pune/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min

Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:

Hapi 1: Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën në Shqipëri në vitet 1945-1990. Punimet e tyre paraqiten në trajte eseje, poster apo poëer point.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Simbolika e “njeriut të ri”

Grupi II:

Jeta e shqiptarëve nën diktaturën komuniste

Grupi III:

Intervista gojore të marra nga të moshuarit-dëshmi të kohës.

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:

Vlerësim në grup për punën e kryer. Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Nuk parashikohen



Veprimtari Praktike: Ideologjizimi i arsimit, artit dhe kulturës në Shqipëri 1945-1990

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema pësimore: Veprimtari Praktike: Ideologjizimi i arsimit, artit dhe kulturës në Shqipëri 1945-1990		Situata e të nxënës: Cilat ishin karakteristikat e arsimit, artit dhe kulturës në Shqipëri në vitet 1945-1990?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Diskuton mbi tiparet e arsimit në Shqipëri gjatë regjimit komunist. - Diskuton mbi e artit dhe kulturës gjatë regjimit komunist. - Tregon si ndikoi politika në këto fusha të jetës. - Lexon e shqyrton informacionin në mënyrë të drejtë. - Fitojnë aftësi në kërkim historik.		Fjalët kyçe: Ideologjizim, edukim marksist-leninist, fletë-rrufe, mësim-punë prodhuese e kalitje vullnetare.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, power point, video projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
FAZA II	Punë në grupe/ Paraqitja	Prezantim/ Diskutim	25'
FAZA III	Paraqitja	Paraqitja e punës/ Shënime	10'

FAZA I: 10min

Në trajtën e një brainstorming, nxënësit rikujtojnë konceptet kryesore të orëve të kaluara. Pas kësaj nxënësve u drejtohen pyetjet të cilat duhet t'i përgjigjen në punimet e realizuara. Nxënësit janë udhëzuar paraprakisht rreth mënyrës së realizimit të veprimtarisë praktike, kështu që në këtë fazë ata fillojnë diskutimin dhe përgatitjet për të prezantuar punimet e tyre me nëntematikat përkatëse.

FAZA II: 25min**Hapat e ndjekur për realizimin e veprimtarisë:****Hapi 1:** Punë individuale jashtë klase

Nxënësit kërkojnë në internet material (tekst) dhe ilustrime (foto, harta) që tregojnë situatën e arsimit, artit dhe kulturës në Shqipëri në vitet 1945-1990. Punimet e tyre paraqiten në trajte eseje, poster apo power point.

Hapi 2:

Nxënësit prezantojnë sipas grupeve përkatëse nëntematikat e caktuara:

Grupi I:

Arimi në Shqipëri në vitet 1945-1990 (ideologjizimi i tij)

Grupi II:

Arti dhe kultura në Shqipëri 1945-1990

Grupi III:

Analizë krahasuese duke e lidhur me situatën e sotme të arsimit, artit dhe kulturës.

FAZA III: 10min

Prezantim i punimit në klasë, diskutim dhe formulim konkluzionesh.

Nxënësit vendosin punimet në Portofolin e tyre të nxënësit.

Vlerësimi:
Vlerësim në grup për punën e kryer. Vlerësim individual i rolit personal në grup për nxënësit që prezantojnë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Lëvizjet shoqërore në Europë dhe SHBA

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Lëvizjet shoqërore në Europë dhe SHBA	Situata e të nxënës: Si mendoni ju pse duhet luftuar racizmi? Shprehni mendimin tuaj.			
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon situatën në Europën pas Luftës së II Botërore - Arsyeton pse bota u përfshi nga lëvizjet shoqërore pas luftës - Përshkruan lëvizjet shoqërore në vitet 1960-1970 - Analizon lëvizjen e Martin Luther King Jr. kundër diskriminimit racial	Fjalët kyçe: Lëvizje feministe, Martin Luter King, Roza Parks, Beti Friedan, Margaret Theçer			
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.			

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës.	Parashtrim me terma paraprake	Diskutim	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Shënime të strukturuar	Punë me tekstin/mbajtje shënimesh	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'.

Mësuesi prezanton temën me anë të situatës së të nxënës dhe krijon një stuhi mendimesh tek nxënësit.

Mendimet e shumicës evidentohen në dërrasë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'.

Pas kësaj nxënësit ndahen në 4 grupe, ku secili merr një detyrë të veçantë. Detyrat sipas grupeve janë:

- 1- Shkaqet e lëvizjeve shoqërore në Europë dhe në SHBA
- 2- Lëvizja bashkëkohore e grave
- 3- Lëvizja e të rinjve
- 4- Lëvizja kundër diskriminimit racial

Pas marrjes së detyrave nxënësit punojnë me çështjet përkatëse në tekst duke mbajtur shënime në fletoret e tyre

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'

Në këtë fazë, nxënësit pasi kanë punuar me tekstin dhe janë në gjendje të nxjerrin përfundime në trajtën diskutimeve para klasës. Përfundimet e nxjerra prej tyre evidentohen në dërrasë.

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Shprehni në një ese qëndrimin tuaj për temën: <i>Bota, për të cilën luftoj...</i>



Jetë paralele: Marti Luther King JR

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Jetë paralele: Marti Luther King JR.		Situata e të nxënit: disa emra historikë frymëzojnë energji të pashembullta për të punuar për jetën e njerëzimit, siç është ajo e udhëheqësit amerikan, në mbrojtje të të drejtave civile, të popullsisë me ngjyrë, por jo vetëm, Martin Luther King JR. Ai nuk kishte lindur udhëheqës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por u bë një i tillë. Fitues i çmimit Nobel në 1964 për mospërdorimin e dhunës në protesta për të drejtat shoqërore. Eksplorojeni jetën e tij dhe zbuloni rrugën që e çoi atë në luftën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon se kush ishte Martin Luther King JR. - Përshkruan së si e mori ai famën e tij. - Analizon se si është nderuar ai nga populli i tij - Analizon shprehjen e M. Luther King JR se: 4 fëmijët e tij një ditë nuk do të gjykohen nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga karakteri i tyre.		Fjalët kyçe: Martin Luther King JR.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i Historisë, fletoret, tabela, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Shpjegim i përparuar	Diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit.	Organizues grafik i informacionit	Paraqitje grafike e informacionit/ plotësim skeme	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi paraqet temën me anë të situatës së të nxënit, duke u ndalur tek disa informacione të përgjithshme lidhur me veprimtarinë e Martin Luther King JR. Ndërkohë nxënësit mbajnë shënime për çështjet që do të trajtohen.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj atyre u kërkohet që për çështjet e parashtruara, në diskutim me njëri-tjetrin, të bëjnë një listë për atë që dinë sipas çështjeve. Pasi nxënësit evidentojnë në listat e tyre gjithçka dinë, mësuesi shpjegon çështjet njëra pas tjetrës, duke drejtuar pyetjen: ç'gjëra të përbashkëta gjeni midis listave tuaja dhe atyre që u përmendën në shpjegim? Ç'të reja mësuat? Gjithashtu nxënësit i drejtojnë mësuesit pyetje për paqartësitë.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit 10'.

Për të verifikuar nivelin e të nxënit, mësuesi organizon në dërrasë një organizues grafik që plotësohet nga përgjigjet e nxënësve.

PLANIFIKIMI DITOR PËR ÇDO TEMË MËSIMORE



Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Përshkruani hapat që ndërmori Martin Luther King JR. Ndërmori për të arritur objektivat e lëvizjes për të drejtat civile të afro-amerikanëve.



Arti, Kultura dhe Arsimi pas 1945

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Arti, Kultura dhe Arsimi pas 1945.		Situata e të nxënës: Ju tashmë në orët e kaluara keni zhvilluar një Veprimtari Praktike në lidhje me tiparet e artit, kulturës dhe arsimit gjatë regjimit komunist dhe vendeve perëndimore. Cilat janë disa nga këto tipare?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan zhvillimet në art, letërsi dhe arsim në periudhën e Luftës së Ftohtë. - Tregon tiparet e artit pas Luftës së II Botërore në vendet e regjimit komunist. - Krahason tiparet e artit, kulturës dhe arsimit në vendet komuniste me ato të Europës Perëndimore. - Argumenton se pse themi që kultura amerikane në këtë periudhë “pushton botën”		Fjalët kyçe: art i realizmit socialist, art modern, rok, Elvis Presli, Bitëllsat, Merlin Monro.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim i ideve	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Lexim i drejtuar/ organizues grafik i informacionit	Lexim ndërveprues/ shënime/ paraqitje grafike e informacionit	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënëit 10’

Nxënësve u tregohen disa foto të personazheve më të spikatura të artit, kulturës dhe arsimit pas viteve 1945. Duke u nisur nga fotot ata shprehin gjithçka dinë për to. Të gjitha idetë e tyre shënohen në dërrasë.



Merlin Monroe




Elvis Presley



Bitëllsat

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25’

Pas kësaj, nxënësit në dyshe, lexojnë duke mbajtur shënime e duke krahasuar atë që parashikuan dhe dinin me atë që po lexojnë. Në këtë mënyrë saktësojnë konceptet paraprake. Nxënësit organizojnë në fletoret e tyre të punës nga një organizues grafik, duke konsideruar të gjitha marrëdhëniet me konceptin “denudim”. Çdo dyshe nxënësish duhet të paraqesë një organizues grafik pak a shumë si ai i mëposhtëm:



PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënëit 10’

Në këtë fazë nxënësve u kërkohet të nxjerrin përfundime, që mësuesi i konsideron të rëndësishme, p.sh: Cilat janë zhvillimet në art, letërsi dhe arsim në periudhën e Luftës së Ftohtë? Pse themi që kultura amerikane “pushton botën”.

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Për emrin e një shkrimtari dhe një piktori përfaqësues, nga vendet e dy blloqeve, gjatë Luftës së Ftohtë.



Kriza e regjimeve komuniste në Bllokun Sovjetik.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Kriza e regjimeve komuniste në Bllokun Sovjetik.		Situata e të nxënit: Modeli sovjetik ka ngjallur pakënaqësi në vendet që është zbatuar. Duke ditur tiparet e këtij modeli, si mendoni ju cilat janë arsyet e këtyre pakënaqësive?		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston shkaqet që çuan në përmbysjen e regjimeve komuniste në vendet e bllokut sovjetik. - Tregon format që opozita përdori kundër regjimit. - Analizon thelbin e perestrojkës. - Analizon arsyet se pse nuk funksionoi perestrojka. - Argumenton se pse modeli sovjetik u kundërshtua nga vet vendet e kampit.		Fjalët kyçe: Aleksandër Solzhenicin, Andrei Saharov, perestrojkë, glasnost, Mihail Gorbaçov, Boris Jeltsin.		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		


FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit.	Diskutim	Diskutim i detyrave të shtëpisë	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Shënime të strukturuar	Organizim grafik i informacionit	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënit.	Shkrim i shpejtë	Punë me shkrim	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënit 10'

Mësuesi orienton nxënësit drejt temës së re me anë të situatës së të nxënit dhe diskutimit të detyrave të shtëpisë. Idetë dhe përfundimet më të arrira të tyre gjatë diskutimit.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Pas kësaj mësuesi paraqet në dërrasë një organizues grafik të informacionit, me anë të të cilit, orienton nxënësit për të mbajtur shënime.



PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'.

Pas kësaj nxënës realizojnë një shkrim të shpejtë me temë: Mesazhi që përcjell secila foto e tekstit tek ju, duke punuar në dyshe. Disa prej shkrimeve lexohen në klasë, ndërsa disa të tjerë mblidhen nga mësuesi/ja, si tregues i nivelit të përvetësimit të koncepteve të temës.

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Kërkoni informacion: Pyesni gjyshërit, cili është përfaqësuesi kryesor i disidentëve në Shqipëri?



Përmbysja e regjimeve komuniste-kalimi i vendeve në demokraci

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Përmbysja e regjimeve komuniste-kalimi i vendeve në demokraci		Situata e të nxënës: Duke u nisur nga njohuritë e orës së kaluar, si mendoni ju cili do ishte fundi i revoltave në vendet e ish Bllokut Sovjetik?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/lëndës sipas kompetencave kyçe: - Liston shkaqet e shpërthimit të revoltave sovjetike në Europën Lindore. - Tregon fundin e modelit sovjetik. - Përshkruan përfundimin e Luftës së Ftohtë. - Arsyeton se pse kalimi në ekonominë e tregut ishte i vështirë.		Fjalët kyçe: Solidarnost, Les Valesa, Vjeshta e popujve		
Burimet / Mjetet / Materialet: teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës	Pyetja sjell pyetjen	Analizë informacioni	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Pyetja sjell pyetjen	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Diskutim	Diskutim përfundimesh	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'.

Duke pasur parasysh që nxënës kanë informacion paraprak për temën, qoftë edhe nga vëzhgimet personale, mësuesi përgatit një sërë pyetjesh “pse” që lidhen me të, duke servitur njëkohësisht fakte të reja nga ana e tij. P. Sh disa nga pyetjet e drejtuara mund të ishin: Pse regjimi komunist shkaktoi pakënaqësi në vendet e ish Bllokut Sovjetik? Si reagon këto popuj?

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'.

Nxënës orientohen të punojnë me tekstin në mënyrë të tillë që të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të shtruaras kështu që ata thellohen të analizojnë të gjejnë shkaqe. Përveç pyetjeve të shtruaras nga mësuesi nxënës nxiten të krijojnë pyetje shkakore që ua drejtojnë shokut të bankës, pasi janë duke punuar në dyshe. Pyetjet e drejtuara ndaj njëri-tjetrit i detyrojnë nxënës t'i rikthehen informacionit për një studim më të thellë. Në këtë mënyrë arrijnë të gjejnë lidhjet shkak-pasojë që lidhen me arsyet e rënies së regjimeve komuniste dhe kalimi i tyre në demokraci.

Arsyet e rënies së modelit sovjetik

1. Rënia ekonomike e Bashkimit Sovjetik në vitet '70.
2. Mobilizimi i SHBA në luftë kundër kampit sovjetik.
3. Reformat liberalizuese të Mihail Gorbaçovit
4. Lëvizjet demokratike në vendet e bllokut.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'.

Të gjithë përfundimet që nxënësit nxorën diskutohen në klasë, duke bërë kujdes i veçantë nga mësuesi që në klasë të prezantohen edhe përfundimet për pyetjet “pse”, të krijuara nga vetë nxënësit. Pyetje “pse” mund të jenë:

- Pse shpërthyen revoltat anti-sovjetike në Europën Lindore?
- Pse kalimi në ekonominë e tregut ishte i vështirë?

Vlerësimi:
Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Formuloni qëndrimet tuaja përmes ilustrimeve. Sillni në klasë ngjarjet e rënies së Komunizmit në Shqipëri.



Ndryshimet në Europë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Ndryshimet në Europë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.		Situata e të nxënës: Lidhni njohuritë e kaluara me temën e re. Lufta e ftohtë si u ndikua nga kriza e Bllokut Sovjetik sipas jush? Nëse iu përmendet emri Slllobodan Millosheviç si mund ta lidhni atë me Shqipërinë dhe Kosovën?		
Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: • Tregon pasojat e Luftës së Ftohtë. • Rendit shkaqet e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. • Liston shkaqet e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. • Pasqyron ndryshimet në hartën politike të Europës në përfundim të Luftës së Ftohtë. • Analizon ndryshimet në Ballkan pas shpërbërjes së Ish Jugosllavisë.		Fjalët kyçe: Gjermani e Bashkuar, Helmut Kol, shpërbërje, konflikt ndëretnik, Slllobodan Millosheviç		
Burimet / Mjetet / Materialet: teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës.	Brainstorming	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes.	Diskutim	Punë me tekstin/ diskutim	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënës.	Përcaktim në hartë i informacionit	Punë me hartën	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënës 10'.

Mësuesi prezanton temën e re me anë të situatës së të nxënës dhe për të krijuar një stuhi mendimesh tek ata ai u drejton pyetje në lidhje me Luftën e Ftohtë dhe ndikimin e saj në Europë dhe Botë; Si dhe çështjet e Kosovës –pavarësia e saj.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'

Nxënësit orientoohen të punojnë me tekstin në mënyrë të tillë që të gjejnë përgjigjet e pyetjeve të shkurtra, në dërrasë nga mësuesi që lidhen me temën e re si:

- Cilat janë pasojat e Luftës së Ftohtë?
- Pse u shpërbë BRSS dhe Jugosllavia?
- Si ndryshoi harta politike e Europës në përfundim të Luftës së Ftohtë?
- Si ndryshoi situata në Ballkan pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë?

Për këtë ata diskutojnë në dyshe e mbajnë shënime në fletore. Pas kësaj përfundimet e nxjerra diskutohen para gjithë klasës e sipas kohës në dispozicion shënohen në dërrasë.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të Nxënës 10'

Në hartën e Europës, në mënyrë të shpejtë disa nga nxënësit tregojnë ndryshimet që pësoi ajo pas përfundimit të Luftës së Ftohtë:



Europa pas shpërbërjes së BRSS dhe Jugosllavisë

Vlerësimi:

Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Formuloni qëndrimet tuaja. Si arriti Kosova që të shpallej Republikë?



Jetë paralele: Mikail Sergejeviç Gorbaçov

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Jetë paralele: Mikail Sergejeviç Gorbaçov.		Situata e të nxënës: disa emra historikë si ai i Mikail Gorbaçov, frymëzojnë respekt për vlerat njerëzore. Si udhëheqës i një vendi superfuqi, ai bëri veprimin e duhur në momentin e duhur, për të bërë kthesën historike të vendit, nga një superfuqi, që përfaqësohej nga një regjim totalitar drejt një vendi të hapur demokratik., duke kursyer kështu jetë njerëzish e duke iu dhënë shpresë për të ardhmen. Në 1990 Gorbaçov nderohet me çmimin “Nobel për Paqen”. Eksplorojeni jetën e tij dhe zbuloni rrugën që e çoi atë në luftën për paqe dhe ekuilibër botëror.		

Rezultatet e të nxënës të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Tregon mënyrën e ardhjes në pushtet të Mikail Gorbaçov. - Përshkruan thelbin e Perestrojkës dhe Gllasnosit. - Argumenton ndikimet e reformave të Gorbaçovit në Rusi. - Analizon arsyet e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. - Vlerëson rëndësinë e figurës historike të Mikail Gorbaçov.	Fjalët kyçe: Mikail Gorbaçov
Burimet / Mjetet / Materialet: teksti i historisë, fletoret, tabela, interneti.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit.	Diskutim për njohuritë paraprake	Diskutim idesh	10'
NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes	Diskutim	Punë me tekstin	25'
PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit.	Organizues grafik i informacionit	Paraqitje grafike e informacionit	10'

PARASHIKIMI: përgatitja për të nxënësit 10'.

Mësuesi/ja prezanton temën me anë të situatës së të nxënësit. Pas kësaj sugjeron një nga konceptet kyçe që lidhen me temën, duke ftuar nxënësit të japin idetë që dinë ose marrëdhëniet që kanë me konceptin p.sh. koncepti kyç i sugjeruar mund të jetë: Perestrojka-gllasnosit ose togfjalëshi- Liberalizim regjimi. Pasi çdo nxënësi ka gjetur diçka për të thënë rreth koncepteve, të cilat janë shënuar në dërrasë, vendoset të kalohet në fazën e dytë.

NDËRTIMI I NJOHURIVE: përpunim i përmbajtjes 25'.

Për të saktësuar idetë lidhur me konceptet dhe marrëdhëniet me konceptin, që tashmë janë paraqitur në dërrasë, nxënësit orientohen të punojnë me informacionin mbi temën, në tekst, duke punuar në dyshe.

PËRFORCIMI: konsolidimi i të nxënësit 10'.

Tashmë nxënësit janë gati për të organizuar informacionin në një formë të caktuar grafike në bazë të një lidhjeje që ata mund të gjejnë. Secili nga nxënësit punon në fletore disa nga organizuesit grafikë që paraqiten në dërrasë.

Fundi i Bashkimit Sovjetik	1. Boris Jelcin, si president i Rusisë ndaloi të gjithë veprimtarinë e Partisë Komuniste
	2. Së bashku me presidentët e Ukrainës dhe Bjellorusisë, nënshkruan traktatin për krijimin e një bashkësie të re të republikave.
	3. Bashkimi Sovjetik u shpërbë pa derdhur gjak

Vlerësimi:

Vlerësim individual ndërnxënës, i përgjigjeve me gojë.

Detyrat dhe puna e pavarur:

Formuloni qëndrimin tuaj. Si vepruan udhëheqësit komunistë në Shqipëri ndaj protestave të studentëve të Dhjetorit për rrëzimin e komunizmit?




Përsëritje: Lufta II Botërore; Bota pas Luftës së II Botërore; Lufta e Ftohtë; Ekonomia gjatë Luftës së Ftohtë; shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europë 1945-1990; Përfundimi i Luftës së Ftohtë

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore:		Situata e të nxënit: Ju tashmë keni marrë përgjigje rreth shumë pyetjeve të shtruara këtë kapitull. Proveni sa të qëndrueshme i keni njohuritë.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përshkruan karakterin dhe qëllimet e OKB - Vlerëson rolin e Planit Marshall në rindërtimin e Europës. - Përshkruan shkaqet e Luftës së Ftohtë dhe krijimin e blloqeve ushtarak. - Përshkruan tiparet kryesore të organizimit ekonomik politik të shteteve perëndimore dhe lindore. - Shpjegon arsyet dhe rrugët drejt integritimit ekonomik politik të shteteve të bllokut perëndimor. - Përshkruan tiparet kryesore të organizimit ekonomik politik të shteteve të bllokut komunist. - Evidenton arsyet e bumit ekonomik në shtetet e bllokut perëndimor. - Përshkruan prirjet e Revolucionit të III Industrial. - Përshkruan mënyrën e jetesës në Europë 1945-1990 - Shqyrton lëvizjet sociale në Europë dhe SHBA duke vlerësuar arritjet e tyre. - Tregon tiparet e reja në art, kulturë, shkencë, arsim në Europën e viteve 1945-1990 - Përshkruan ngjarjet që shënuar përfundimin e Luftës së Ftohtë - Përcakton lëvizjet antikomuniste që transformuan shtetet komuniste në shoqëri demokratike - Evidenton në hartën politike të Europës ndryshimet territoriale të pas Luftës së Ftohtë.		Fjalët kyçe: Luftë civile, Stalingrad, Ushtria e kuqe, Hiroshima, Nagasaki, holokaust, Aushvic, kampe përqendrimi, Konferencë e Paqes, OKB, çmilitarizim, armë bërthamore, Luftë e Ftohtë, Perde e Hekurt, Superfuqi, liberalizëm modern, ekonomi mikse, shoqëri e konsumit, modeli sovjetik, Luftë e Ftohtë, blloqe ushtarake, NATO, traktati i Varshavës, Plan Marshall, KNER, Revolucion i Tretë Shkencor, Gllasnost, Perestrojkë, Bashkimi European		
Burimet / Mjetet / Materialet: Teksti i historisë, Historia e Shqipërisë, Interneti, Mjete didaktike, postera, powerpoint, video projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, shkencat shoqërore		

FAZAT E STRUKTURËS	STRATEGJITË MËSIMORE	VEPRIMTARITË E NXËNËSIT	KOHA
FAZA I	Parashikim (Stuhi Mendimesh)	Diskutim idesh	5'
FAZA II	Harta e Koncepteve të kapitullit	Organizim grafik i informacionit	20'
FAZA III	Diskutim	Diskutim përfundimesh	20'

FAZA II: 20min

Klasa ndahet në disa grupe me të njëjtën detyrë: organizimi i pemës së koncepteve të kapitullit, çdo anëtar i grupit sugjeron lidhje dhe kontribuon në shtimin e “degëve” të pemës. Pema e mundshme e ndonjërit prej grupeve mund të ishte:



FAZA III:20min

Pas kësaj secili nga grupet marrin detyra specifike, të cilat i deklarojnë të zgjidhura para klasës. Secili nga nxënësit teston veten me pyetjet për përsëritje që gjenden në tekst.

Vlerësimi:
Vetëvlerësim, Vlerësim i përgjigjeve me gojë, vlerësim i aftësisë për të punuar individualisht dhe në grup.
Detyrat dhe puna e pavarur:
Nuk parashikohen



Testim: Lufta II Botërore; Bota pas Luftës II Botërore; Lufta e Ftohtë; Ekonomia gjatë Luftës së Ftohtë; shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europë 1945-1990; Përfundimi i Luftës së Ftohtë.

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE	Fusha: Mjedisi dhe shoqëria	Lënda: Histori	Klasa: VIII	Shkalla: IV
Tema mësimore: Testim: Lufta II Botërore; Bota pas Luftës II Botërore; Lufta e Ftohtë; Ekonomia gjatë Luftës së Ftohtë; shoqëria, arti, kultura dhe arsimi në Europë 1945-1990; Përfundimi i Luftës së Ftohtë.		Situata e të nxënit: Ju tashmë e dini se qëndrueshmëria e njohurive tuaja matet me një vlerësim përmbljedhës që është i detyrueshëm në fund të çdo tremujori.		
Rezultatet e të nxënit të temës mësimore/ lëndës sipas kompetencave kyçe: - Përdor informacionin në mënyrën e duhur - Seleksionon informacionin sipas nevojës. - Analizon situatë e lidhje të ndryshme - Demonstron aftësi për të krahasuar. - Demonstron aftësi për të interpretuar. - Shpreh aftësi për të nxjerrë përfundime. - Formon shprehje të punës së pavarur. - Mëson të shprehë formimin me shkrim		Fjalët kyçe: përshkrim, analizë, vlerësim, interpretim, përfundime		
Burimet / Mjetet / Materialet: Fleta e testit në të njëjtin format për çdo nxënë		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: TIK-u, Shkencat shoqërore.		

FAZAT E STRUKTURËS

FAZA I: 5min

Mësuesi orienton nxënësit lidhur me kërkesat e formatit të testit dhe shpërndan testet.

FAZA II:40min

Nxënësit marrin testin që është unik dhe punojnë gjatë gjithë orës.

FAZA III:5min (nga koha e pushimit)

Sapo bie zilha testet mbledhen dhe janë objekt i vlerësimit të vazhduar.

SRUKTURA E MËSIMIT: TJETËR

Pyetjet për testim nga : Bashkimi Europian dhe Prirjet e Qytetërimeve sot.
Rretho alternativën e saktë:

1. Shkak i fillimit të Luftës së II Botërore ishte:

- a. Pushtimi gjerman i Polonisë.
- b. Pushtimi gjerman i Bashkimit Sovjetik
- c. Pushtimi gjerman i Francës
- d. Pushtimi gjerman i Ballkanit

2. Me përfundimin e Luftës së II Botërore:

- a. Filloi Lufta e Ftohtë
- b. Bashkimi Sovjetik u bë superfuqi
- c. Në Gjermani u vendos komunizmi
- d. Italia vazhdoi me regjimin fashist.

3. Plani Marshall i hartuar nga Xhorxh Marshall synoi:

- a. Ndihmën ekonomike ndaj vendeve të Europës Perëndimore.
- b. Ndihmën ekonomike të Europës Lindore
- c. Aleancë politike ushtarake midis bllokut perëndimor
- d. Aleancë politike ushtarake në Bllokun Sovjetik

4. Lufta e Ftohtë u zhvillua midis:

- a. SHBA dhe Gjermanisë
- b. SHBA dhe Bashkimit Sovjetik
- c. SHBA dhe Italisë
- d. SHBA dhe Japonisë

5. Martin Luter King luftoi për të mbrojtur:

- a. Të drejtat e fëmijëve
- b. Të drejtat e njerëzve me aftësi të kufizuara
- c. Të drejtat e njerëzve me ngjyrë
- d. Të drejtat e emigrantëve në Amerikë

6. Shteti i Mirëqenies Sociale kishte në thelb:

- a. Ndihmë ekonomike për të papunët-sigurimet sociale dhe shoqërore për punëtorët.
- b. Ndihmën ndaj regjimeve diktatoriale
- c. Ndihmë ushtarake për vendet që e aplikuan
- d. Aleancën politike ushtarake midis kombeve

7. KNER-synonte:

- a. Ndihmën ekonomike për vendet e Bllokut Sovjetik
- b. Ndihmën ushtarake për vendet e Bllokut Sovjetik
- c. Formimin e një koalicioni politik në vendet perëndimore
- d. Ndërhyrjen diplomatike për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

8. Zonja e hekurt u quajt:

- a. Margaret Theçer
- b. Simone Beavoir
- c. Merlin Monroe
- d. Maore

9. Gllasnosti dhe Perestrojka ishin reforma të hartuara nga:

- a. Mikail Gorbaçov

